



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 11 regjistër (JR)
Datë 21.02.2019

Nr. 25 i vendimit
Datë 01.10.2020

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga gjyqtarët:

Ardian Hajdari	Kryesues
Sokol Çomo	Relator
Albana Shtylla	Anëtare
Ina Rama	Anëtare
Natasha Mulaj	Anëtare

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 01.10.2020, ora 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në Tiranë, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Steven Kessler, me Sekretare Gjyqësore Adelajda Hiska, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 11 (JR), datë 21.02.2019, që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit Luan Dervishi, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Apelit Shkodër, përfaqësuar nga av. Ardian Visha, me nr. licence {***}, anëtar i Dhomës së Avokatisë Tiranë, sipas prokurës së përgjithshme me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 03.12.2018, në prani të noteres A. A. M.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 83, datë 26.11.2018, që i përket subjektit të rivlerësimit Luan Dervishi.

BAZA LIGJORE: Neni 62 e vijues, neni 66, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi mbi bazë dokumentesh, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi ankimin, sipas shkaqeve të parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, i cili kërkoi përfundimisht ndryshimin e vendimit nr. 83, datë 26.11.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe konfirmimin e tij në detyrë, dëgjoi gjyqtarin relator të çështjes Sokol Çomo, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit, në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, ushtronte detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Apelit Shkodër, për rrjedhojë ai gëzonte statusin e magjistratit¹. Duke qenë se subjekti i rivlerësimit ishte kandidat për anëtar të Gjykatës Kushtetuese dhe në vijim edhe për anëtar të Këshillit të Lartë Gjyqësor, në zbatim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës dhe nenit 276, pika 4 e ligjit nr. 115/2016² “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, ai iu nënshtrua procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio* dhe me përparësi në kohë.
2. Subjekti i rivlerësimit ka plotësuar dhe dërguar pranë institucioneve kompetente dhe brenda afatit ligjor³, në përputhje me nenet 31, pika 1, 35, pika 1 dhe 41, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, përkatësisht deklaratën e pasurisë⁴, deklaratën për kontrollin e figurës⁵ dhe formularin e vetëvlerësimit profesional⁶.
3. Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, dërgoi pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, duke konstatuar se:
 - (i) *Deklarimi nuk është i saktë, në përputhje me ligjin dhe ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor.*
 - (ii) *Ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë.*
 - (iii) *Nuk ka kryer fshehje të pasurisë.*
 - (iv) *Nuk ka kryer deklarim të rremë.*

¹Neni 2, pika “gj” e ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” parashikon se magjistrat është edhe gjyqtari, ndërkohë neni 164, pika 2 e të njëjtit ligj parashikon se gjyqtarët në detyrë gëzojnë statusin e magjistratit të parashikuar sipas të njëjtit ligj, vetëm nëse kalojnë me sukses procesin e rivlerësimit.

²Neni 276, pika 4 e ligjit nr. 115/2016 parashikon: “4. Brenda 3 muajve nga data e dorëzimit të shprehjes së interesit dhe dokumentacionit, sipas pikës 1, të këtij neni, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit bën rivlerësimin e gjyqtarëve që kandidojnë [...]”.

³Afati ligjor prej 30 ditësh nga hyrja në fuqi e ligjit për dorëzimin e deklaratës së pasurisë, kontrollit të figurës dhe formularit të vetëvlerësimit profesional, ka përfunduar më datë 31.01.2017.

⁴Dorëzuar pranë ILDKPKI-së më datë 24.01.2017, sipas vërtetimit të ILDKPKI-së me nr. {***} prot., datë 24.01.2017. Të njëjtën datë mban edhe deklarata e pasurisë në rubrikën përkatëse.

⁵Dorëzuar pranë Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, më datë 24.01.2017.

⁶Referuar raportit nr. {***} prot., datë 16.10.2018, të Inspektoratit pranë KLD-së për “Analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit Luan Dervishi për periudhën 08.10.2013 deri më 08.10.2016”, formulari i vetëvlerësimit profesional është dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit pranë KLD-së, më datë 24.01.2017.

(v) *Subjekti gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

4. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) kreu kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklaramëve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit kishte kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016, dhe dërgoi një raport të arsyetuar pranë Komisionit, bazuar në nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, me konstatimin për përshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit për vazhdimin e detyrës. Ky raport, në vijim, është rishikuar nga grupi i punës dhe i është përcjellë Komisionit, me konstatimet e mëposhtme.

◦ *Për subjektin e rivlerësimit Luan M. Dervishi disponohen të dhëna ku ngrihen dyshime për përfshirje në veprime korruptive, gjatë gjykimit të një çështjeje penale.*

◦ *Grupi i punës gjykon se, nisur nga informacionet që disponohen për subjektin e rivlerësimit, për implikim në veprimtari korruptive të funksionarit të drejtësisë, në formën e mitmarries, për të kryer apo mos kryer një veprim që lidhet me detyrën e tij funksionale, e bën subjektin në fjalë person me tendenca për përfshirje në veprimtari kriminale dhe një individ që mund të vihet lehtësisht nën presion nga strukturat kriminale.*

Për rrjedhojë, grupi i punës ka rishikuar konstatimin fillestar të kontrollit të figurës së subjektit të rivlerësimit Luan Dervishi dhe ka arritur në përfundimin mbi papërshtatshmërinë e këtij subjekti për vazhdimin e detyrës.

5. Inspektorati pranë KLD-së ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të 5 dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, dhe ka dërguar pranë Komisionit një raport të hollësishëm⁷ dhe të arsyetuar mbi subjektin e rivlerësimit, bazuar në nenin 43 të ligjit nr. 84/2016.
6. Bazuar në nenin Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, pasi administroi raportet e vlerësimit të hartuara për subjektin e rivlerësimit nga ILDKPKI-ja, DSIK-ja dhe Inspektorati pranë KLD-së, kreu procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin në fjalë, bazuar në tri kriteret e vlerësimit (vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale), duke marrë vendimin nr. 83, datë 26.11.2018.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

7. Komisioni, me vendimin nr. 83, datë 26.11.2018, vendosi: “Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Luan Dervishi, gjyqtar në Gjykatën e Apelit Shkodër [...]”.
8. Ky vendim është marrë bazuar në nenet Ç, D, Dh, E dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës, si dhe në nenin 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016, në vijim të konkluzioneve të mëposhtme, për secilin prej tri kriterëve të rivlerësimit.

8.1. *Në lidhje me vlerësimin e pasurisë, subjekti ka kryer deklaramëve të pasakta dhe që vijnë në kundërshtim me germën “a”, pika 5, neni 33 i ligjit nr. 84/2016; nuk ka pasur burime të ligjshme për justifikimin e pasurive, bazuar te germa “b”, pika 5, neni 33 i ligjit nr. 84/2016; ka kryer fshehje pasurie, bazuar te germa “c”, pika 5, neni 33 i ligjit nr. 84/2016; ka kryer deklaram të*

⁷ Dërguar me shkresën nr. {***} prot., datë 16.10.2018.

rremë, bazuar te germa “c”, pika 5, neni 33, i ligjit nr. 84/2016; ka qenë në kushtet e konfliktit të interesit, bazuar te germa “a”, pika 5, neni 33 i ligjit nr. 84/2016.

8.2. Në lidhje me kontrollin e figurës, Komisioni, bazuar në provat e dokumentet që disponon dhe vlerësimin e çështjes në tërësi në lidhje me kriterin e figurës, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk rezulton me probleme serioze gjatë kontrollit të figurës, pasi në raportin e dërguar nga ana e DSIK-së vlerësimi i kryer nuk përmban rrethanat që merren parasysh në konstatimin se ekziston një kontakt i papërshtatshëm me një person të përfshirë në krimin e organizuar, dhe prandaj Komisioni arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës. Në këto kushte, Komisioni çmon se konstatimet në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës, nuk mund të konsiderohen si shkak për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit sipas nenit 61, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

8.3. Në lidhje me vlerësimin e aftësive profesionale, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka demonstruar mungesë të aftësive organizative të një gjyqtari. Përfundimet e nxjerra nga dokumentacioni që disponon nga Ministria e Drejtësisë dhe faktet e bëra publike në media dhe shqyrtimi i pavarur i këtij rasti në tërësinë e tij, janë të pamjaftueshme për t’u konsideruar si shkaqe për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit sipas parashikimeve të nenit 61, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, por ato merren në konsideratë në vlerësimin tërësor të çështjes së subjektit të rivlerësimit, sipas nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

III. Shkaqet e ankimit

9. Subjekti i rivlerësimit iu drejtua Kolegjit të Posaçëm të Apelimit me ankim kundër vendimit të Komisionit nr. 83, datë 26.11.2018, me pretendimin se ky vendim nuk është produkt i shqyrtimit objektiv dhe i vlerësimit të drejtë të fakteve dhe provave të administruara në proces. Sipas subjektit të rivlerësimit, Komisioni nuk ka qenë në gjendje të interpretojë dhe të zbatojë në mënyrë korrekte ligjin nr. 84/2016 dhe se, në disa aspekte të çështjes, nuk ka lejuar zhvillimin e debatit dhe shqyrtimin e provave, duke konkluduar në mënyrë të njëanshme në vlerësimin e tyre; Komisioni sipas subjektit të rivlerësimit është treguar subjektiv, i njëanshëm dhe me standarde të dyfishta, pasi është bazuar në dyshime të paqena e përfundime jologjike.
10. Subjekti, bazuar në nenin 66 të ligjit nr. 84/2016, kërkoi që Kolegji të marrë në shqyrtim shkaqet e ankimit dhe të vendosë:
 - Gjykimin e çështjes në seancë publike.
 - Riçeljen e hetimit gjyqësor dhe pranimin e provave të reja (veçanërisht ato që lidhen me shlyerjen e detyrimit për pagimin e makinës për personin e lidhur me subjektin e rivlerësimit, shtetasin E. D.).
 - Përfundimisht, prishjen e vendimit nr. 83, datë 26.11.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhënë ndaj gjyqtarit të Gjykatës së Apelit Shkodër, zotit Luan Dervishi, e konfirmimin e tij në detyrë.
11. Në vijim, më datë 25.09.2020, 6 ditë përpara datës së caktuar për gjykimin e çështjes në dhomë këshillimi, subjekti i rivlerësimit, në kuadër shqyrtimit të ankimit të tij, ka depozituar në Kolegji kërkesën me objekt “Riçelje të hetimit gjyqësor dhe marrjen e provave të reja në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit”, të cilën e ka shoqëruar me disa akte shkresore dhe e ka bazuar në nenet 47, 48, 49 dhe 55 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e

mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 49/2012”) dhe nenet 65 dhe 66, germa “c” e ligjit nr. 84/2016.

12. Shkaqet e ankimit lidhur me aspektet procedurale, parashtrohen në mënyrë të përmbledhur si më poshtë.

12.1. Cenim i së drejtës për një proces të rregullt ligjor duke qenë se procesi i Komisionit ka qenë paragjykses, i mbingarkuar dhe dëmtues i rëndë e i padrejtë i imazhit të subjektit të rivlerësimit, veçanërisht për sa i përket kontrollit të figurës, edhe pse rezultati final i vlerësimit të këtij kriteri rezultoi pozitiv.

13. Shkaqet e ankimit për kriterin e vlerësimit të pasurive, paraqiten në mënyrë të përmbledhur si më poshtë.

◦ Lidhur me pasurinë “tokë truall”, me sip. 365 m², në {***}, në bashkëpronësi me të tjerë, me pjesë takuese 46,8 m²:

13.1. Përfundimi i Komisionit lidhur me këtë pasuri nuk është produkt i prejardhur logjiksht nga shqyrtimi i faktit objekt analize.

13.2. Përfundimi lidhur me deklaratën noteriale, datë 20.11.2018, nuk ka lidhje logjike, evidenton fakte që nuk kanë asnjë relevancë me këtë deklaratë noteriale dhe, për rrjedhojë, konkluzioni i Komisionit mbi këtë pasuri, mbi bazën e kësaj deklarate noteriale, nuk është ndërtuar drejt, por edhe në substancë nuk u përgjigjet fakteve të çështjes.

◦ Lidhur me pasurinë apartament banimi me sip. 125 m², si dhe një garazh me sip. 40 m², ndodhur në rr. “{***}”, me vlerë ndërtimi 2.500.000 lekë:

13.3. Konkluzioni i Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të rremë, lidhur me këto pasuri, si pasojë e mospërputhjeve në deklarime, lidhur me burimin e krijimit të këtyre pasurive dhe paqartësisë se cili është burimi i krijimit të tyre, është konkluzion i gabuar.

13.4. Konkluzioni i Komisionit për pamjaftueshmëri të të ardhurave të ligjshme për krijimin e këtyre pasurive në vitin 1998, në vlerën prej 1.346.010 lekësh, është i pabazuar, si pasojë e vlerësimit të gabuar nga Komisioni lidhur me (i) të ardhurat e krijuara nga shitja e dy pasurive të paluajtshme në vitet 1997 dhe 1998; (ii) periudhën kohore në të cilën ka kryer analizën financiare për efekt të vlerësimit të mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për krijimin e këtyre pasurive; (iii) të ardhurat nga punësimi i subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes së tij për rreth 10 vite punë të deklaruar.

◦ Lidhur me të ardhurat nga qiraja e apartamentit të mësipërm dhe garazhit për vitet 2013, 2014 dhe 2015:

13.5. Konkluzioni i Komisionit lidhur me të ardhurat e deklaruara nga qiraja e apartamentit të mësipërm, është i gabuar, pasi nuk mbështetet në ligj dhe pasi Komisioni ka gabuar në moskonsiderimin si të ligjshme të të ardhurave nga qiraja e apartamentit për vitet 2013 dhe 2014 dhe vlerësimin e tyre si të ardhura të paligjshme, pasi për to nuk është paguar tatimi përkatës.

13.6. Konkluzioni i Komisionit për deklaram të rremë, si pasojë e mospërputhjes së vlerës së përfituar të qirasë, referuar deklarimeve të viteve 2014 dhe 2015, dhe kontratës së qirasë, është i pabazuar.

◦ Lidhur me shitjen me kusht dhe rezervë të apartamentit të banimit me sip. 125 m² dhe garazhit ndodhur në rr. “{***}”:

13.7. *Komisioni ka arritur në konkluzion të gabuar dhe të pambështetur në ligj lidhur me këtë pasuri të paluajtshme të subjektit të rivlerësimit, sipas të cilit subjekti vlerësohet se ka kryer deklaram të rremë të kësaj pasurie, vetëm se kontrata për shitjen me kusht dhe rezervë nuk është zbatuar rregullisht nga palët sipas kushteve të saj.*

13.8. *Komisioni ka gabuar në vlerësimin se si pasojë e faktit se dy pagesat e para për shlyerjen e kësteve të blerjes së apartamentit janë kryer nga z. N. D, në cilësinë e administratorit të një shoqërie tjetër, deklarami i kryer nga subjekti është deklaram i rremë.*

◦ Në lidhje me garazhin me sip. 20 m²:

13.9. *Subjekti i rivlerësimit kundërshton si të pabazuar konkluzionin e Komisionit për fshehje dhe paraqitje të pasaktë të numrit dhe të sipërfaqes së saktë të garazheve në posedim.*

13.10. *Subjekti i rivlerësimit kundërshton si të gabuar konkluzionin e Komisionit për pamjaftueshmëri të burimeve të ligjshme për blerjen e këtyre garazheve.*

◦ Lidhur me depozitën e krijuar pranë Bankës Credins në vitin 2009, në shumën prej 1452.532,06 lekësh:

13.11. *Komisioni ka arritur në konkluzion të gabuar dhe të pambështetur në prova, sipas të cilit subjekti ka kryer deklaram të rremë në deklaratën e pasurisë (vetting) të burimit të krijimit të depozitës në Credins Bank, duke qenë se depozita në Credins Bank është krijuar nga tërheqja në datën 05.03.2009, e vlerës monetare që ndodhej e depozituar pranë Raiffeisen Bank.*

◦ Lidhur me automjetin, tip “Ford Focus”:

13.12. *Deklarimi i kësaj pasurie, ndryshe nga sa konkludon Komisioni, është i saktë dhe në përputhje me ligjin.*

13.13. *Subjekti kundërshton konkluzionin e Komisionit për deklaram të rremë të mënyrës së shlyerjes së çmimit të automjetit dhe argumenton se mënyra e ekzekutimit të kushteve të kontratës lidhur me pagesën e çmimit të saj (në një apo dy këste), është çështje që lidhet me vullnetin e palëve dhe nuk mund të vlerësohet si shkelje apo deklaram i rremë.*

13.14. *Komisioni ka arritur në konkluzion të gabuar dhe të pabazuar në prova, sa i takon fshehjes nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë vetting, të huasë së marrë z. B. Ç dhe mungesës së burimeve financiare të ligjshme për blerjen e automjetit.*

◦ Lidhur me blerjen e aksioneve “Bono privatizimi”, subjekti i rivlerësimit e pranon se ndodhet teorikisht në një situatë konflikti interesi, por deklaron se vullneti për blerjen e këtyre aksioneve nuk është diktuar nga dëshira për t’u angazhuar në një veprimtari të mirëfilltë biznesi, por ka ardhur si rrjedhojë e statusit të bashkëshortes së tij, si e punësuar pranë kompanisë që po privatizohet. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit sqaron se aksionet e tij në këtë kompani kapin vlerën e vetëm 0,0005% të kapitalit të saj dhe se gjatë periudhës nga viti 2007 e deri tani, nuk ka marrë asnjë qindarkë nga këto aksione, si dhe se nga viti 2009 shoqëria {***} ka pasur bilanc negativ.

- Lidhur me likuiditetin në gjendje *cash*, në vlerën prej 1.100.000 lekësh:

13.15. *Konkluzioni i Komisionit mbi paqartësinë, lidhur me destinacionin e përdorimit të shumës prej 10.000 USD, të deklaruar gjendje cash në vitin 2011, është i pabazuar në prova, duke qenë se destinacioni i kësaj vlere monetare është deklaruar si kursime për vitin 2011, në deklaratën periodike të pasurisë në vitin 2011 dhe në vijim.*

- Lidhur me banesën me sip. 60 m², me vendndodhje në Tiranë, në pronësi të personit tjetër të lidhur, znj. M. Sh. (vjehera e subjektit të rivlerësimit), në të cilën subjekti banon aktualisht:

13.16. *Konkluzioni i Komisionit se subjekti i rivlerësimit është përpjekur të fshehtë këtë pasuri, duke e regjistruar atë në emër të personit tjetër të lidhur, znj. M. Sh., është një përfundim që nuk bazohet në prova, logjikë dhe fakte. Dyshimet e Komisionit, lidhur me fshehjen e kësaj pasurie, mbështeten në hamendësime.*

- Lidhur me të ardhurat e personit të lidhur (djalit të subjektit të rivlerësimit E. D) që kanë shërbyer për blerjen e automjetit tip "Toyota Camry", me vlerë 64.000 USD, dhe pagesat për shkollimin e vajzës së subjektit të rivlerësimit, si dhe lidhur me të ardhurat dhe shpenzimet e personit të lidhur (vajzës së subjektit të rivlerësimit A. D.):

13.17. *Subjekti kundërshton si të gabuar dhe të pabazuar konkluzionin e Komisionit, sipas të cilit subjekti ka fshehur shpenzimet reale të shkollimit të vajzës së tij, ku sipas dokumentacionit rezultuan 8.721.836,651 lekë, ndërkohë që subjekti ka deklaruar vetëm 5.128.950 lekë.*

13.18. *Subjekti kundërshton si të pabazuar edhe konkluzionin e Komisionit se në deklaratet periodike të viteve 2012, 2013 dhe 2014, ai ka kryer deklarim të rremë në lidhje me burimin e financimit të studimeve të vajzës duke deklaruar se i ka financuar ato nga të ardhurat e tij.*

13.19. *Subjekti i rivlerësimit kundërshton si të pabazuar në fakte dhe prova konkluzionin e Komisionit lidhur me mos shpjegimin bindshëm të burimit dhe ligjshmërisë së të ardhurave të personit të lidhur, djalit të tij E. D. dhe dorëzimin e dokumentacionit ligjor justifikues për pagimin e kësteve të kredisë për blerjen e automjetit në vlerën prej 64.000 USD, si dhe të shumës prej 15.000 USD për pagesën e shkollës së personit të lidhur, vajzës së subjektit të rivlerësimit.*

- Lidhur me të ardhurat e deklaruara nga subjekti në deklaratën e pasurisë *vetting*:

13.20. *Subjekti i rivlerësimit pretendon se përfundimi i Komisionit, sipas të cilit subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë me dokumentacion justifikues ligjor të ardhurat në vlerën prej 5.175.400 lekësh, është i pabazuar në prova dhe fakte. Komisioni, në mënyrë të paligjshme dhe të pajustificuar, nuk ka përllogaritur të ardhurat e subjektit të rivlerësimit me burimet e mëposhtme.*

- *Të ardhurat e krijuara nga shitja e banesës prej 900.000 lekësh në vitin 1997 dhe e zyrës së avokatisë prej 500.000 lekë në vitin 1998, edhe pse në vendim Komisioni i ka vlerësuar si të ardhura të ligjshme.*
- *Të ardhurat e siguruara nga puna e subjektit të rivlerësimit për vitet 1989-1993 dhe të ardhurat e bashkëshortes për vitet 1989-1992.*
- *Të ardhurat e përfituara nga ushtrimi i veprimtarisë private, avokat, për periudhën mars 1995 - mars 1998.*
- *Të ardhurat në vlerën prej 10.000 USD, të përfituara nga puna e djalit për vitet 2010-2011.*
- *Të ardhurat nga qiraja e banesës për vitet 2013-2014, në vlerën prej 1.100.000 lekësh.*

- *Të ardhurat e siguruara nga depozitat bankare, kryesisht për periudhat 1997-1999, prej 1.300.000 lekësh. Lidhur me këto të ardhura, subjekti parashtron se, për sa kohë kjo shifër është produkt i deduksionit të tij dhe ka karakter relativ, të paktën të konsiderohet vlera e depozitës bankare në Bankën e Kursimit, në masën prej 897.807 lekësh.*

- *Lidhur me analizimin financiar të deklarimeve të subjektit të rivlerësimit ndër vite:*

13.21. *Konkluzioni i Komisionit se subjekti i rivlerësimit, në deklarin periodik të vitit 2007, ka fshehur depozitat pranë “Credins Bank”, në emër të bashkëshortes, në vlerë totale prej 2.002.000 lekësh, më datë 31.12.2007, është një përfundim jo i drejtë dhe jo i vërtetë.*

13.22. *Subjekti kundërshton konkluzionin e Komisionit lidhur me mosdeklarimin në vitin 2012, në rubrikën “detyrime”, të shumës së pashlyer të huasë së marrë në vitin 2011, në vlerën prej 7000 eurosh, duke pretenduar se deklarimi i tij lidhur me këtë hua, nga momenti i marrjes deri në shlyerjen e saj, ka qenë i saktë.*

13.23. *Subjekti kundërshton si të pabazuar konkluzionin e Komisionit për mungesë të mjeteve monetare për të justifikuar krijimin e pasurive, shtesave në likuiditete dhe shpenzimet e deklaruara për vitet 2013 dhe 2014.*

13.24. *Lidhur me konkluzionin e Komisionit mbi ekzistencën e mospërputhjeve ndërmjet deklarimeve periodike vjetore të viteve 2014 dhe 2015, lidhur me kursimet në gjendje cash, subjekti i rivlerësimit shpjegon se është e vërtetë që ai ndryshe nga vitet e tjera, në periudhën 2013-2014 dhe 2015, nuk i ka deklaruar të ardhurat e tij në vlerën neto, por ky fakt nuk përbën shkelje të ligjit apo mosdeklarim të saktë.*

13.25. *Lidhur me përfundimet e arritura nga Komisioni mbi pasaktësitë në deklarime, sa u takon kursimeve të vitit 2005 dhe mosdeklarimit të shtesave në llogarinë e pagës në “Raiffeisen Bank” në vitin 2006, subjekti i konfirmon si të drejta këto përfundime dhe sqaron se këto të meta janë konstatuar edhe nga ILDKPKI-ja, për të cilat është mbajtur edhe një procesverbal, të cilin e ka dorëzuar në cilësinë e provës pranë Komisionit.*

13.26. *Gjithashtu, edhe sa i takon përfundimit të Komisionit lidhur me mosdeklarimin e depozitës në vlerën 1.857.717 lekë pranë “Raiffeisen Bank” në vitin 2008, si dhe të 5 transfertave të kryera nga llogaria e bashkëshortes së tij në USD, me vlerë totale prej 19.692,25 USD, subjekti pranon si të drejta këto konstatime të Komisionit, por pretendon se, pavarësisht sa më sipër, operacionet e kryera me anë të këtyre vlerave monetare janë të deklaruara në deklarinet periodike dhe se kanë qenë rezultat i të ardhurave të ligjshme të familjes së tij.*

14. *Shkaqet e ankimit në lidhje me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale parashtrihen në mënyrë të përmbledhur, si më poshtë.*

14.1. *Vlerësimi i Komisionit, lidhur me këtë kriter të rivlerësimit, ka qenë tendencioz, i njëanshëm, me standard të ulët profesional dhe në shkelje të hapur me dispozitat e ligjit nr. 96/2016 dhe të ligjit nr. 84/2016, duke qenë se Komisioni, për vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, ka përzgjedhur për të marrë në shqyrtim 3 vendime gjyqësore në lëndë penale të vitit 2017, dhe jo vendimet e shtrënguar sipas procedurës ligjore.*

14.2. *Konkluzioni i Komisionit se subjekti i rivlerësimit në çështjen gjyqësore me të pandehur “S. M.” ka demonstruar mungesë të aftësive organizative të një gjyqtari, është i pabazuar, për sa kohë ky përfundim lidhet me drejtimin e procesit gjyqësor për këtë çështje dhe përgjegjësia për këtë është e kryesuesit të trupit gjykues, që në rastin në fjalë nuk ka qenë subjekti i rivlerësimit.*

IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Mbi aspektet procedurale të gjykimit

a) Juridiksioni i Kolegjit

15. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji, si e vetmja gjykatë e procesit të rivlerësimit, ka juridiksion (*ratione materiae*) për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin e subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur për rivlerësimin e subjektit të rivlerësimit Luan Dervishi, duke e shkarkuar atë nga detyra, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

b) Legjitimimi i ankuesit

16. Ankuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh⁸ nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016. Ankimi i subjektit të rivlerësimit është nënshkruar nga avokati i tij me prokurë, z. Ardian Visha, dhe është shoqëruar me aktin e përfaqësimit⁹, në përputhje me parashikimet e nenit 46, pika 1 e ligjit nr. 49/2012.

c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

17. Në përputhje me nenin 65 të ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga subjekti i rivlerësimit, si rregull bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomën e këshillimit, përveç rasteve kur trupi gjykues në vijim vendos se plotësohen kriteret e përcaktuara në nenin 51 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, e cila lidhet me shqyrtimin e vendimit të Komisionit nr. 83, datë 26.11.2018, bazuar në shkaqet e ngritura në ankimin e subjektit të rivlerësimit, u mor në shqyrtim nga Kolegji në dhomë këshillimi.
18. Trupi gjykues, pasi shqyrtoi kërkesën e subjektit të rivlerësimit për çelje të hetimit gjyqësor dhe marrjen e provave të reja, kontrolloi zhvillimin e procesit të rivlerësimit në Komision, si dhe vlerësoi dokumentacionin e fashikullit të administruar gjatë hetimit në Komision, arriti në përfundimin që, edhe pse aktet e dorëzuara në cilësinë e provave të reja përmbushin kriteret e parashikuara në nenin 47 të ligjit nr. 49/2012, hetimi i mëtejshëm nga ana e Kolegjit dhe marrja e

⁸ Siç rezulton nga aktet e administruara në fashikullin gjyqësor, vendimi i Komisionit nr. 83, datë 26.11.2018, për rivlerësimin e subjektit Luan Dervishi, i është njoftuar subjektit të rivlerësimit me shkresën nr. {***} prot., datë 22.01.2019, dhe avokatit të tij, z. Ardian Visha, me shkresën nr. {***} prot., datë 22.01.2019, konfirmuar kjo e fundit sipas lajmërim-marrjes, më datë 23.01.2019, kurse ankimi i subjektit të rivlerësimit është depozituar pranë Komisionit më datë 05.02.2019, protokolluar në Komision me nr. {***}, datë 05.02.2019, që rezulton të jetë dita e 13-të e afatit ligjor për të ushtruar ankim, në përputhje me nenin 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.

⁹ Prokurë e përgjithshme nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 02.12.2018, para noteres së Dhomës së Noterisë Tiranë A. A. M.. Nëpërmjet këtij akti përfaqësimi, subjekti i rivlerësimit ka pajisur përfaqësuesin e tij, z. A. Visha, me tagrin e apelimit të vendimeve në kundërshtim me të drejtat dhe interesat e tij të ligjshëm dhe kryerjen, në mungesë të tij, të çdo procedure të nevojshme pranë Komisionit dhe Kolegjit.

këtyre akteve në cilësinë e provës nuk janë të nevojshëm, pasi Kolegji mund të arrijë në vendim lidhur me këtë çështje, nga shqyrtimi mbi bazën e dokumenteve të administruara në fashikullin e Komisionit. Për rrjedhojë, trupi gjykues vijoi me shqyrtimin e çështjes në dhomën e këshillimit, sipas parashikimeve të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar.

B. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit me natyrë procedurale

19. Lidhur me shkakun e ankimit për cenim të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, subjekti i rivlerësimit pretendoi se procesi i kryer nga Komisioni ka qenë paragjykses, i mbingarkuar dhe dëmtues i rëndë e i padrejtë i imazhit të subjektit të rivlerësimit, veçanërisht për sa i përket kontrollit të figurës, edhe pse rezultati final i vlerësimit të këtij kriteri rezultoi pozitiv.
20. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkakut ankimi, trupi gjykues konstatoi se pretendimet për cenim të procesit të rregullt ligjor i referohen më së shumti dëmtimit të padrejtë të imazhit të subjektit të rivlerësimit, si pasojë e vlerësimit të DSIK-së në raportin e saj, përcjellë Komisionit, për përshtatshmëri në vazhdimin e detyrës për subjektin e rivlerësimit Luan Dervishi. Lidhur me këtë pretendim, trupi gjykues konstaton se, referuar parashikimeve kushtetuese dhe atyre ligjore, mbi të cilat kryhet kontrolli i figurës, konkretisht nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 34, 36, 39 dhe 45 të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja, si strukturë përgjegjëse për kontrollin e figurës, ka përgatitur raportin e vlerësimit, i cili i është nënshtruar hetimit të thelluar dhe të pavarur të Komisionit dhe, në përfundim të këtij procesi, ka rezultuar që Komisioni, ndryshe nga DSIK-ja, ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit Luan Dervishi është i përshtatshëm për të vijuar detyrën.
21. Në këto kushte, për sa kohë procesi i vlerësimit të kriterit të kontrollit të figurës ka ndjekur procedurën ligjore, pretendimi i subjektit se konkluzioni negativ i DSIK-së ka dëmtuar imazhin e tij, gjendet i pabazuar nga trupi gjykues. Ndërkohë, sa u takon pretendimeve për proces paragjykses, trupi gjykues konstaton se ato nuk janë argumentuar nga ana e subjektit të rivlerësimit. Për më tepër, nga shqyrtimi i akteve të fashikullit gjyqësor, nuk u konstatuan të dhëna që provojnë qëndrimin paragjykses të trupit gjykues të Komisionit në zhvillimin e procedurës së rivlerësimit për këtë subjekt, për rrjedhojë, trupi gjykues i gjen të pabazuara këto pretendime dhe shkakun e ankimit të ngritur mbi bazën e tyre.

C. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit, lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë

22. Lidhur me pasurinë “tokë truall” me sip. 365 m² në {***}, Tiranë, në bashkëpronësi me të tjerë, me pjesë takuese 46,8 m², për të cilën subjekti i rivlerësimit pretendon se konkluzioni i arritur nga Komisioni nuk është produkt i prejardhur logjikisht nga shqyrtimi i faktit objekt analize, trupi gjykues konstaton si vijon.
23. Komisioni, në kontrollin dhe vlerësimin e kësaj pasurie gjatë procesit të rivlerësimit, është shprehur në vendim:
Komisioni, pasi shqyrtoi dhe analizoi shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka mospërputhje deklarimesh në lidhje me mënyrën e fitimit të pronësisë së truallit ku ai është bashkëpronar në 1/8 pjesë të sipërfaqes prej 365 m², truall për ndërtim, referuar deklaratës “vetting” të vitit 2017 dhe përgjigjeve të pyetësorit nga njëra anë dhe deklaratimit në deklaratën e interesave private, për herë të parë, në vitin 2003. [...] Subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë se personat e tjerë të lidhur/dhuresit e këtij trualli kishin të ardhura nga burime të ligjshme për këtë dhurim të bërë, sipas detyrimit të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016. Në lidhje me provën e re të dërguar nga ana e subjektit të rivlerësimit, deklaratën noteriale, datë 20.11.2018, Komisioni çmon se kjo deklaratë ka vetëm efekt deklarativ për të konfirmuar faktin, por ajo nuk provon të ardhurat e

ligjshme të dhuruesit. Si konkluzion, subjekti i rivlerësimit, z. Luan Dervishi, ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme nga ana e z. Sh. B. për të justifikuar vlerën e truallit të dhuruar atij.

24. Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi vendimin e Komisionit, me pretendimin se përfundimi i Komisionit lidhur me këtë pasuri, nuk është produkt i prejardhur logjikisht nga shqyrtimi i faktit objekt analize, për sa kohë gjatë procesit të rivlerësimit, objekt i shqyrtimit nga ana e Komisionit ka qenë fakti i vënies në diskutim dhe provueshmëria e pagesës prej 2400 USD, ose e kundërvlerës së saj në monedhën shqiptare, si kundërshtëpërblim për blerjen e truallit prej 48 m² në vitin 1998, ndërkohë që, në përfundim, Komisioni ka kërkuar nga subjekti të provojë se personat e tjerë të lidhur me të (dhuruesit e këtij trualli) kishin burime të ligjshme për dhurimin. Sipas subjektit të rivlerësimit, të gjithë porositësit (pranuesit e dhurimit të truallit), pavarësisht kontratës së dhurimit, kanë paguar ndaj dhuruesve vlerën respektive prej 2400 USD dhe, për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit pretendoi se ai nuk ka asnjë detyrim për të provuar burimet financiare të z. Sh. B., në vitin 1998, në kushtet kur cilësia e dhuruesit të këtij trualli ka qenë thjesht formale.
25. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit kundërshtoi si alogjik përfundimin e Komisionit lidhur me deklaratën noteriale të Sh. dhe H. B. me nr. {***} rep., nr. {***} kol., të datës 20.11.2018, para noterit L. D., përfundim ky i cili, sipas subjektit të rivlerësimit, evidenton fakte që nuk kanë asnjë relevancë me këtë deklaratë noteriale dhe, për rrjedhojë, konkluzioni i Komisionit lidhur me vlerësimin e kësaj pasurie të paluajtshme, mbi bazën e kësaj deklarate noteriale, nuk është ndërtuar drejt dhe në substancë nuk u përgjigjet fakteve të çështjes.
26. Në vlerësim të këtij shkaku ankimi, nga shqyrtimi i akteve të fashikullit të Komisionit, trupi gjykues konstatoi fillimisht ekzistencën e mospërputhjeve sa u takon deklaratimeve të subjektit të rivlerësimit, lidhur me origjinën e kësaj pasurie të paluajtshme, konkretisht në deklaratën e pasurisë *vetting*, ku deklarohet se kjo pasuri rrjedh nga një marrëdhënie dhurimi¹⁰ dhe në deklaratën për herë të parë, në vitin 2003, ku deklarohet se kjo pasuri e paluajtshme ka një vlerë prej 2400 USD dhe si burim krijimi për të kanë shërbyer “të ardhurat nga puna”. Ekzistenca e mospërputhjeve rezulton të jetë fakt i pakundërshtuar edhe nga vetë subjekti, i cili në përgjigjet e tij ndaj pyetësorëve të Komisionit ka shpjeguar: *[...] ndërsa në kontratën e dhurimit, kam nënshkruar pa njohur arsyen e vërtetë, pasi nuk kam qenë pjesë e negociatave për shkaqet e mësipërme, pasi kisha hyrë me vonesë, kontratën e sipërmarrjes e kam nënshkruar pasi jam njohur me përmbajtjen e saj. Më pas më ka sqaruar znj. H. B. se, ndonëse është përpiluar kontrata e dhurimit, të gjithë porositësit kanë paguar vlerën e truallit. Me këtë rast, unë duhet t'i paguaja vlerën e truallit porositësit që ishte larguar nga kontrata, kunatit të znj. H. B.. Lidhur me këtë fakt, unë bëra verifikimet e duhura dhe kam gjetur kopje të deklaratës së lëshuar nga znj. H. B., së cilës i kam paguar në dy këste shumën prej 354.600 lekësh, që përfaqëson çmimin e truallit për 1/8 e sipërfaqes totale.*
27. Lidhur me këtë fakt, trupi gjykues çmoi të nevojshme të vlerësojë nëse kjo mospërputhje në deklarime arrin të prodhojë pasojat e një deklarimi të pamjaftueshëm, në kuadër të parashikimeve të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Për efekt të këtij vlerësimi, në kuadër të kontrollit ndaj vendimit të Komisionit lidhur me këtë pasuri të subjektit të rivlerësimit, referuar shkaqeve të ngritura në ankim, u çmua me rëndësi, së pari, përcaktimi i origjinës së pasurisë së paluajtshme të llojit “tokë truall” me sip. 365 m², në të cilën subjekti i rivlerësimit ka fituar bashkëpronësinë në 1/8 pjesë të saj, element përcaktues ky në vlerësimin në vijim të

¹⁰ Sipas kontratës nr. {***} rep., nr. {***}, datë 25.09.1998, para noterit N.K.

mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për krijimin e saj, në kuadër të parashikimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe dispozitave të kreut IV të ligjit nr. 84/2016.

28. Në kontekst të sa më sipër, sa i takon momentit të kalimit të pronësisë së pasurisë së paluajtshme “tokë truall” me sip. 365 m² edhe në emër të subjektit të rivlerësimit, në cilësinë e bashkëpronarit, nga shqyrtimi i akteve të fashikullit, u konstatuan faktet dhe rrethanat si më poshtë.
- a. Me anë të kontratës noteriale të shitblerjes me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 28.08.1998, përpara noteres R. S., z. M. M. dhe z. Sh. B. kanë blerë nga 9 bashkëpronarët B., një “tokë truall” me sip. 365 m², në {***} të Tiranës, me çmimin prej 2.000.000 lekësh, i cili referohet në kontratë se është likuiduar në total nga blerësit.
 - b. Në datën 25 shtator 1998, me anë të kontratës noteriale “Dhurim trualli” me nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., në prani të noteres N. K., z. M. M. dhe z. Sh. B. kanë lidhur një kontratë dhurimi me anë të së cilës u kanë dhuruar pranuesve të dhurimit z. A. B., znj. E. Sh., z. M. M., z. I. M., z. Luan Dervishi, z. H. B. dhe z. Q. N., përkatësisht si vijon: z. M. M. nga pjesa e tij e pandarë prej 187,5¹¹ m² u dhuron pranuesve të dhurimit një pjesë të truallit me sip. 140,7 m²; ndërsa dhuruesi Sh. B. u dhuron pranuesve të dhurimit të gjithë pjesën e tij të pandarë prej 187,5 m², duke u zhveshur në këtë mënyrë nga pronësia mbi truallin objekt kontrate. Për rrjedhojë, dhuruesi M. M. bëhet pronar për 46,8 m² në pjesë të pandarë dhe të gjithë pranuesit e dhurimit (përfshirë subjektin e rivlerësimit Luan Dervishi), sipas kësaj kontrate dhurimi, bëhen bashkëpronarë në pjesë të barabarta dhe të pandara të truallit prej 328,2 m².
 - c. Me kontratën noteriale të sipërmarrjes me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 25 shtator 1998, para noteres së Dhomës së Noterisë Tiranë N. K., bashkëpronarët e truallit me sip. 365 m², sipas kontratës së sipërcituar të dhurimit, kanë porositur ndërtimin e një godine 5-katëshe nga sipërmarrësi M. L., në truallin në pronësi të tyre.
 - ç. Në dosjen¹² fizike të dokumentacionit të administruar nga ALUIZNI, në kuadër të praktikës për legalizimin e objektit të ndërtuar, sipas kontratës së sipërcituar të sipërmarrjes, u konstatua edhe prokura e posaçme me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 11.08.1998, para noteres M. S.. Sipas kësaj prokure të posaçme, të përfaqësuarit T. B. dhe H. B. kanë caktuar si përfaqësuesit e tyre Sh. dhe H. B., me këto tagra: *që të dy së bashku apo veç e veç të tërheqin nga Banka e Kursimeve Berat gjithë shumën e lekëve që ne kemi depozitë pranë kësaj banke, duke pasur ata të drejtë që këtë shumë prej 2.000.000 lekësh ta administrojnë për blerje ose ndërtime të një banese ose lokali në qytetin e (Beratit) prishet një fjalë, e Tiranës. Ata kanë të drejtë të blejnë truall si dhe të lidhin kontrata sipërmarrëse [...].*
 - d. Referuar deklaratës noteriale¹³ nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 20.11.2018, të dhënë para noterit publik L. D. nga Sh. B. dhe H. B., kjo e fundit deklaroi shprehimisht: *Unë H. B. deklaroj se z. Luan Dervishi, me të cilin kam lidhje shoqërore sipas deklarimeve të mësipërme të bashkëshortit tim, më ka dorëzuar mua, me dy deklarata dore, shumën prej 354.600 lekësh (treqind e pesëdhjetë e katër mijë e gjashtëqind lekë), e cila është e barsvlefshme me shumën prej 2400 USD (dymijë e katërqind dollarë amerikanë sipas kursit të kohës), që përfaqëson vlerën e truallit të paguar më parë nga kunati im, B. B..*
 - dh. Subjekti i rivlerësimit, gjatë hetimit administrativ të Komisionit, ka përcjellë pranë këtij të fundit dy shkresa të thjeshta të nënshkruara nga znj. H. B., sipas të cilave kjo e fundit

¹¹ Konstatohet që kjo shifër është gabim në kontratë pasi për sipërfaqen e pandarë të truallit prej 365 m², dy dhuruesit duhet të jenë bashkëpronar në pjesë të barabarta prej 182,5 m² dhe jo 187,5 m².

¹² Administruar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ me shkresën e ALUIZNIT nr. {***} prot., datë 25.10.2018.

¹³ Dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit në kuadër të barrës së provës mbi rezultatet e hetimit lidhur me këtë pasuri.

deklaron marrjen e pagesës (në dy këste) prej subjektit të rivlerësimit Luan Dervishi të shumës totale prej 354.600 lekësh, që përfaqëson vlerën e kësaj pasurie (trullit), të paguar në emër të I. B.. Sipas deklaratës së datës 16.10.1998, znj. H. B. shprehet: *Me shlyerjen e kësaj vlere¹⁴, z. Luan nuk ka më asnjë detyrim lidhur me shlyerjen e trullit [...]*.

29. Në vlerësim të rrethanave dhe fakteve si më sipërcituar, konstatohet se akti juridik me anë të të cilit është kryer tjetërsimi i pasurisë së paluajtshme të llojit “tokë truall” me sip. 365 m², është kontrata e dhurimit nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 25.09.1998, e lidhur në prani të noteres N. K., mes z. M. M. dhe z. Sh. B., në cilësinë e dhuruesve të pasurisë dhe pranuesve të dhurimit, ndër to edhe subjekti i rivlerësimit Luan Dervishi dhe z. H. B.. Ky i fundit është personi që, në konsideratë të përmbajtjes së prokurës së posaçme me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 11.08.1998, mendohet të ketë financuar blerjen nga z. M. M. dhe Sh. B. të pasurisë së paluajtshme të sipërcituar nga bashkëpronarët B., në datën 28.08.1998. Ndërkohë z. Sh. B., i cili, sipas prokurës së sipërcituar, ka blerë për llogari të z. H. B. truallin prej 365 m², rezulton se në datën 25.09.1998 është zhveshur nga bashkëpronësia mbi truallin nëpërmjet dhurimit të të gjithë pjesës së tij të pandarë prej 187,5 m², çka vlerësohet si e dhënë në drejtim të faktit që në të vërtetë z. Sh. B. ka shërbyer si një ndërmjetës në këtë transaksion. Rrethanat faktike si më sipër dhe dy deklaratat e znj. H. B. (bashkëshortja e z. Sh. B. dhe ish-bashkëpunëtore e subjektit të rivlerësimit), në vlerësimin e trupit gjykues, qëndrojnë në harmoni me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se, ndonëse është përpiluar kontrata e dhurimit të truallit, të gjithë porositësit e kanë paguar vlerën e blerjes së tij. Për pasojë, trupi gjykues vlerëson se Komisioni, pavarësisht faktit se marrëdhëniet juridike të krijuara mes palëve të përfshira në shitblerjen dhe dhurimin e kësaj pasurie të paluajtshme, janë komplekse dhe deri diku të paqarta, referuar të dhënave të sipërcituara, duhet t’i kishte vlerësuar si bindëse shpjegimet e subjektit të rivlerësimit në drejtim të të provuarit të faktit se pasuria e paluajtshme tokë truall *de facto* nuk i ishte dhuruar, por ai e kishte financuar pjesën e tij takuese.
30. Për më tepër, trupi gjykues vlerëson se edhe pse *de jure* tjetërsimi i pasurisë së paluajtshme është realizuar me një kontratë dhurimi, ajo çka merr vlerë për efekt të procesit të rivlerësimit është fakti nëse *de facto* subjekti i rivlerësimit ka kryer shpenzime për krijimin e kësaj pasurie, rast në të cilin do duhet të verifikohet nga ana e organeve të rivlerësimit mjaftueshmëria e burimeve të ligjshme financiare të përdorura.
31. Për rrjedhojë, në përfundim të sa më sipër, edhe pse origjina e krijimit të kësaj pasurie të paluajtshme është një kontratë dhurimi, për sa kohë në deklaratën për herë të parë të vitit 2003, subjekti ka deklaruar si shpenzim për krijimin e kësaj pasurie, vlerën prej 2400 USD, dhe në vijim, gjatë procesit të hetimit administrativ ka dhënë shpjegime të hollësishme lidhur me këtë deklaram, duke i qëndruar këtij deklarami deri në fund, pavarësisht se në deklaratën e pasurisë *vetting* ka deklaruar aktin ligjor (kontratën e dhurimit) që ka shërbyer për kalimin e titullit të bashkëpronësisë mbi këtë sipërfaqe trualli, trupi gjykues arrin në përfundimin se, për nevojat e këtij procesi, mjaftueshmëria e burimeve të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie nga ana e subjektit të rivlerësimit duhet të ishte vlerësuar nga Komisioni në drejtim të marrëdhënies së faktit të blerjes, dhe jo asaj juridike të dhurimit, sipas parashikimeve të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016. Në këtë kontekst, përfundimi i arritur nga ana e Komisionit se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë se personat e tjerë të lidhur/dhuruesit e këtij trualli kishin të ardhura nga burime të ligjshme për këtë dhurim të bërë, sipas detyrimit të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, nuk gjendet i drejtë dhe i bazuar nga trupi gjykues. Në vijim të këtij përfundimi të trupit gjykues, u kryen edhe verifikimet e nevojshme në Kolegj, lidhur me verifikimin e mundësisë për të

¹⁴ I referohet këtu kësaj pasurie të vlerësuar prej 56.400 lekësh.

financuar blerjen e kësaj pasurie, nga ku u konstatua se subjekti i rivlerësimit kishte burime të ligjshme të mjaftueshme për të mbuluar shpenzimin e deklaruar për krijimin e kësaj pasurie të paluajtshme.

32. Në përfundim, subjekti i rivlerësimit, lidhur me këtë pasuri, ndodhet vetëm në kushtet e deklarimit të pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin, për origjinën e krijimit të saj në deklaratën e pasurisë *vetting*, duke qenë se nuk ka deklaruar në mënyrë të plotë dhe të saktë situatën komplekse lidhur me origjinën e kësaj pasurie.

33. *Lidhur me vlerësimin e pasurisë “apartament banimi”, me sipërfaqe 125 m², si dhe një garazh me sip. 40 m², ndodhur në rr “{***}”, Tiranë, me vlerë ndërtimi 2.500.000 lekë, për të cilën subjekti i rivlerësimit pretendoi se përfundimet e Komisionit nuk janë të bazuara, nuk janë produkt i rrjedhur nga analiza e provave dhe e fakteve, por rrjedhje e konkluzioneve të bazuara në indicie dhe deduksione që nuk përputhen ose nuk përqasen me gjendjen reale të fakteve, trupi gjykues konstaton si më poshtë.*

34. Komisioni, në përfundim të procesit të rivlerësimit, ka arsyetuar në vendimin e tij lidhur me krijimin e këtyre pasurive të paluajtshme: *Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar burime të ndryshme të krijimit të kësaj pasurie ndër vite dhe ka deklaruar data të ndryshme të përfundimit të punimeve se kur ai ka filluar të banojë, si dhe, referuar analizës ekonomike, ai nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme në shumën prej 1.346.010 lekësh, për investimin në ndërtimin e këtij apartamenti dhe garazhi, sipas kësteve të paguara, referuar kontratës së sipërmarrjes, si dhe shpenzimet për mobilimin e shtëpisë.*

Për sa më sipër, Komisioni arsyeton se subjekti i rivlerësimit në lidhje me këtë pasuri ka kryer deklarim të rremë. Duke iu referuar deklaramenteve të tij në vitin 2003 pranë ILDKPKI-së, deklaratës “vetting” dhe në përgjigje të pyetësorit, ka mospërputhje të deklaramenteve, ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar blerjen e pasurisë dhe mobilimin e saj.

Subjekti i rivlerësimit nuk provoi me dokumentacion justifikues ligjor shumën e të ardhurave të siguruar nga viti 1989, kur ka filluar punë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Librazhd, për periudhën 1989 - dhjetor 1992, me cilësinë e kryetarit të gjykatës. Për sa më sipër, Komisioni arsyeton se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të ardhurat gjatë këtyre viteve, që kanë shërbyer si burim për ndërtimin e këtij apartamenti dhe garazhi.

Subjekti i rivlerësimit nuk provoi bindshëm burimin dhe se ka shlyer detyrimet tatimore në lidhje me periudhën kur ai kishte ushtruar aktivitetin si avokat, në mars 1995 – mars 1999. Në lidhje me këtë, Komisioni arsyeton se subjekti i rivlerësimit nuk shpjegoi bindshëm burimin e ligjshëm të të ardhurave nga avokatia, pasi për këto të ardhura nuk janë paguar detyrimet tatimore sipas ligjit dhe, për këtë arsye, këto të ardhura nuk merren në konsideratë, bazuar në nenin D, pika 4 e Aneksit të Kushtetutës.

Në lidhje me pagimin e detyrimeve tatimore për të ardhurat e përfituara nga shitja e banesës dhe zyrës në qytetin e Librazhdit, përkatësisht në vitet 1997 dhe 1998 (në vlerën 42.000 lekë). Referuar ligjit nr. 7786, datë 27.01.1994, “Për tatimin mbi të ardhurat personale”, të ndryshuar, të ardhurat e realizuara nga shitja e pasurive të paluajtshme taten në masën 3% të çmimit të shitjes, subjekti i rivlerësimit nuk duhej ta paguante, pasi ligji për këtë taksë ka hyrë në fuqi në vitin 1998.

35. Subjekti i rivlerësimit, në kuadër të kundërshtimit të vlerësimit që Komisioni u ka bërë këtyre pasurive të paluajtshme, ka ngritur shkaqet e mëposhtme në ankimin e tij.

35.1. Konkluzioni i Komisionit, se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të rremë lidhur me këto pasuri, si pasojë e mospërputhjeve në deklarime lidhur me (i) burimin e krijimit të këtyre pasurive, (ii) paqartësinë se cili është burimi i krijimit të tyre dhe (iii) deklarime të ndryshme

lidhur me datën e fillimit të ndërtimit të banesës dhe përfundimit të punimeve, si dhe fillimit të banimit për herë të parë në këtë godinë, është konkluzion i gabuar. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se burimin e krijimit të këtyre pasurive e ka pasqyruar në deklaratën e pasurisë *vetting* ose më pas, në deklaratimet e dhëna në përgjigjet ndaj Komisionit, të cilat, sipas tij, kanë qenë në pajtim me deklaratën e pasurisë *vetting*. Ndërkohë, sa i takon pohimit të parë të dhënë Komisionit nëpërmjet përgjigjeve të pyetësorit, se në godinën 5-katëshe ka filluar të banojë në gusht të vitit 1998, subjekti pretendoi se ky ka qenë një lapsus. Subjekti pretendoi se ky fakt është i besueshëm, pasi sipas tij nuk ka pasur asnjë mundësi objektive që ai të fillonte të banonte në gusht të vitit 1998, për faktin e thjeshtë që punimet për ndërtimin kanë filluar pas lidhjes së kontratës së sipërmarrjes, në vjeshtë të vitit 1998. Në kuadër të sa më sipër, subjekti pretendoi se, në kundërshtim me sa arsyeton Komisioni, ai asnjëherë nuk ka deklaruar se data e lidhjes së kontratës së sipërmarrjes ka qenë pas përfundimit të punimeve.

35.2. Konkluzioni i Komisionit për pamjaftueshmëri të të ardhurave të ligjshme për krijimin e këtyre pasurive në vitin 1998, në vlerën prej 1.346.010 lekësh, është i pabazuar, si pasojë e vlerësimit të gabuar lidhur me:

- (i) Qëndrimin e Komisionit mbi të ardhurat e krijuara nga shitja e dy pasurive të paluajtshme në vitet 1997 dhe 1998 (shtëpi banimi dhe zyrë avokatie), i cili, sipas subjektit, është kontradiktor. Subjekti pretendoi se, ndonëse Komisioni ka pranuar që mospagesa e tatimit mbi të ardhurat nga shitja e këtyre pasurive është në përputhje me legjislacionin e kohës, nuk i ka llogaritur këto të ardhura, si të ardhura që kanë shërbyer për krijimin e dy pasurive apartament banimi dhe garazh në vitin 1998.
- (ii) Komisioni, në mënyrë të gabuar, ka vlerësuar si të pamjaftueshme burimet e ligjshme për krijimin e këtyre dy pasurive të paluajtshme, bazuar në analizën financiare për periudhën deri më 31.12.1998, ndërkohë që detyrimi për pagesat e kësteve është përmbushur në fund të vitit 1999. Komisioni në mënyrë të padrejtë nuk ka llogaritur të ardhurat nga puna për subjektin e rivlerësimit dhe bashkëshorten e tij për periudhën në fjalë.
- (iii) Mosmarrjen në konsideratë të një periudhe punësimi të siguar, prej afro 10 vitesh, për subjektin e rivlerësimit dhe bashkëshorten e tij, me pretendimin që për këtë periudhë subjekti nuk paraqiti dokumentacion justifikues për të ardhurat e krijuara. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se Komisioni duhet ta merrte kryesisht këtë provë, nëpërmjet caktimit të një eksperti për përlogaritjet e pagesave të marra lidhur me periudhat e sigurimit, duke qenë se subjekti i rivlerësimit ka qenë në pamundësi objektive për të paraqitur dokumentacionin justifikues lidhur me të ardhurat e krijuara në këto periudha kohore. Subjekti i rivlerësimit, me ankimin e tij, kërkoi nga Kolegji zgjerimin e hetimeve për marrjen e provës, për sqarimin e fakteve lidhur me këtë pretendim.

36. Në vlerësim të shkakut të ankimit të parashtruar në nënparagrafin 35.1, nga shqyrtimi i dokumentacionit të fashikullit u konstatua sa më poshtë.

- *Lidhur me deklarimin e burimit të krijimit të pasurive*

a) Subjekti i rivlerësimit, në deklaratën e pasurisë *vetting* ka deklaruar si burim të ardhurat e krijuara nga puna ndër vite midis meje dhe bashkëshortes sime, ndërkohë në deklarimin e parë që u ka bërë këtyre pasurive në DIPPV-në e vitit 2003, ka deklaruar si burim: *rrjedhur nga të ardhurat nga puna: *marrëdhënie pune me shtetin; *të ardhura nga puna si avokat; shitja e shtëpisë së privatizuar 950000 lekë; shitja e një zyre 500000 lekë*. I pyetur gjatë procesit të rivlerësimit lidhur me burimin e krijimit të këtyre pasurive, subjekti është shprehur: *Burimi kryesor i të ardhurave kanë qenë kursimet e rrjedhura nga kontributi në punë midis meje dhe bashkëshortes sime. Burime të tjera, jo nga puna, kanë qenë: (i) shitja e banesës në masën prej*

900.000 lekësh, fakt i deklaruar dhe (ii) shitja e zyrës së punës – avokatisë - Librazhd, në masën prej 500.000 lekësh, fakt i deklaruar.

b) Banesa e deklaruar, e shitur në vlerën 900000 lekë, sipas kontratës noteriale të shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 24.11.1997, rezulton të jetë pasuri e paluajtshme (apartament, 1 dhomë, 1 kuzhinë me aneks), e cila është privatizuar në emër të subjektit të rivlerësimit, sipas kontratës për privatizimin e banesës, të lidhur më datë 22.07.1993, mes NK Banesa Librazhd dhe subjektit të rivlerësimit, me vlerën prej 18512 lekësh.

c) Zyra e avokatisë me sip. 20 m², e cila është shitur sipas “Kontratë shitblerje objekti e trualli” nr. {***} rep., nr. {***} kol., më datë 18.08.1998, është ndërtuar sipas Vendimit të Bashkisë së qytetit të Librazhdit me nr. {***} prot., datë 12.12.1994, “Për dhënie shesh ndërtimi” dhe Vendimit nr. {***}, datë 3.3.1995, të Këshillit të Rregullimit të Territorit Librazhd “Për dhënie leje ndërtimi” për zyrë avokatie, me vlerë të preventivuar 35.360 lekë, mbi truallin e blerë më vonë prej shtetit nga subjekti i rivlerësimit, sipas kontratës së shitblerjes nr. {***} rep., datë 12.01.1996, të zyrës së noterisë Librazhd.

37. Në vlerësim të fakteve dhe rrethanave të mësipërme, trupi gjykues arrin në përfundimin se deklarimi i subjektit të rivlerësimit lidhur me burimin e krijimit të pasurive të sipërcituara, nuk paraqet problematikë në drejtim të deklarimit të rremë, për sa kohë rezulton se mospërputhjet në deklarime nuk janë produkt i të dhënave jo të vërteta, duke qenë se burimet e deklaruara janë burime ekzistuese, janë deklaruar si të tilla që në deklarimin e parë të subjektit të rivlerësimit në DIPPV-në e vitit 2003 dhe janë në pajtim me burimin e deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting*, pasi në thelb të ardhurat e krijuara nga shitja e dy pasurive të paluajtshme janë rrjedhojë e investimit të kryer nga subjekti i rivlerësimit me të ardhurat e krijuara nga puna e tij dhe e bashkëshortes ndër vite. Pavarësisht kësaj, trupi gjykues çmon se deklarimi i burimit të krijimit të kësaj pasurie në deklaratën e pasurisë *vetting*, nuk përmbush kërkesat e nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, për t’u vlerësuar deklarim i saktë, në përputhje me ligjin, pasi subjekti i rivlerësimit nuk ka identifikuar në mënyrë të plotë, saktësisht dhe individualisht burimet që kanë shërbyer për krijimin e kësaj pasurie të paluajtshme në momentin e krijimit, sikundër edhe i pretendon, detyrim ky i cili i buron në mënyrë të drejtpërdrejtë nga neni D, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe neni 31, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.
38. Lidhur me deklarimet e subjektit mbi datën e fillimit dhe përfundimit të punimeve të godinës objekt i kontratës së sipërmarrjes dhe datës së fillimit të banimit në apartamentin e përfutur sipas kësaj kontrate, trupi gjykues vlerëson se këto janë rrethana fakti, të cilat rrjedhin nga dokumentacioni ligjor lidhur me zhvillimin e pasurisë së paluajtshme “tokë truall” me sip. 365 m² dhe zbatimi në praktikë i sipërmarrjes së kontraktuar, por nuk janë objekt deklarimi i deklaratës së pasurisë *vetting*. Në këtë kuptim, deklarimet e subjektit lidhur me rrethanat e sipërcituara, edhe nëse do të ishin kontradiktore, në vlerësim të trupit gjykues nuk arrijnë ta vendosin subjektin e rivlerësimit në situatën e deklarimit të rremë lidhur me pasurinë objekt kontrolli.
39. Për më tepër, pas shqyrtimit të dokumentacionit të fashikullit të Komisionit lidhur me krijimin e pasurisë së paluajtshme “tokë truall” dhe zhvillimin e saj sipas kontratës së sipërmarrjes në një objekt prej 5 katësh, trupi gjykues nuk konstatoi asnjë të dhënë apo indicie që në mënyrë të arsyeshme të mund ta çonte Komisionin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit mund të ketë filluar të banojë në godinën e ndërtuar në muajin gusht të vitit 1998, përveç deklarimit fillestar të subjektit të rivlerësimit, në përgjigjet e pyetësorit të datës 25.09.2018, fakt për të cilin në vijim ai ka deklaruar se ka qenë një lapsus i tij. Nga analiza e akteve të fashikullit të çështjes, lidhur me momentin e shitblerjes së truallit nga bashkëpronarët B., në datën 28.08.1998 dhe zhvillimin e tij në një godinë 5-katëshe, sipas kontratës së sipërmarrjes së lidhur më datë 25 shtator 1998, si dhe

nga shqyrtimi i mandatpagesës së lëshuar më datë 04.08.1999, në përshkrimin e së cilës deklarohet se likuidohet kësti IV dhe i fundit (gjithsej 2.500.000 lekë), këst ky i cili, sipas parashikimit në kontratën e sipërmarrjes, duhej të kryhej në kohën e marrjes në dorëzim të objektit, trupi gjykues arrin në përfundimin se shpjegimi i subjektit për lapsus në deklarim është bindës dhe, për rrjedhojë, bindës vlerësohet edhe pretendimi i tij se si moment i fillimit të banimit në këtë apartament, ka qenë gushti i vitit 1999 dhe jo gushti i vitit 1998.

40. Në përfundim të sa më sipër, trupi gjykues e gjen të bazuar shkakun e ngritur në ankim nga subjekti i rivlerësimit, se konkluzioni i Komisionit për deklarim të rremë nga ana e subjektit të rivlerësimit, si pasojë e mospërputhjeve në deklarime lidhur me burimin e krijimit të këtyre pasurive dhe deklarimeve të ndryshme lidhur me datën e fillimit të ndërtimit të banesës, përfundimit të punimeve, si dhe fillimit të banimit për herë të parë në këtë godinë, është konkluzion i gabuar.
41. Sa i takon shkakut të ankimit në nënparagrafin 35.2, lidhur me kundërshtimin e përfundimit të arritur nga Komisioni mbi pamjaftueshmërinë e të ardhurave të ligjshme për të justifikuar investimin e kryer për fitimin e këtyre pasurive të paluajtshme, trupi gjykues vlerëson si më poshtë.

41.1. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se qëndrimi i Komisionit mbi të ardhurat e krijuara nga shitja e dy pasurive të paluajtshme në vitet 1997 dhe 1998 (shtëpi banimi dhe zyrë) është kontradiktor, trupi gjykues konstaton se ndërsa në vendim Komisioni, lidhur me të ardhurat e krijuara nga shitja e këtyre dy pasurive të paluajtshme, ka arsyetuar: *Referuar ligjit nr. 7786, datë 27.01.1994, "Për tatimin mbi të ardhurat personale", të ndryshuar, të ardhurat e realizuara nga shitja e pasurive të paluajtshme tatohen në masën 3% të çmimit të shitjes, subjekti i rivlerësimit nuk duhej ta paguante pasi ligji për këtë taksë ka hyrë në fuqi në vitin 1998 [...], në analizën financiare të kryer për vlerësimin e mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për krijimin e pasurive të paluajtshme në vitin 1998, sipas kontratës së sipërcituar të sipërmarrjes, rezulton se këto të ardhura nuk janë përfshirë në zërin e të ardhurave të hyra.*

41.2. Në shqyrtim të këtij kontradiksioni të konstatuar në vendimin e Komisionit, trupi gjykues çmoi të arsyeshme verifikimin e situatës ligjore lidhur me trajtimin e të ardhurave me burim kalimin e pronësisë së pasurisë së paluajtshme në kohën e tjetërsimit të pasurive të subjektit të rivlerësimit. Nga verifikimet e kryera, lidhur me legjisllacionin e kohës në të cilën janë kryer shitjet e dy pasurive të paluajtshme, konstatohet se referuar ligjit nr. 8189, datë 30.01.1997, "Për miratimin me ndryshime të dekretit nr. 1673, datë 20.12.1996, "Për tatimin mbi të ardhurat personale", ndryshuar me ligjin nr. 7823, datë 18.5.1994, ligjin nr. 7897, datë 2.2.1995 dhe ligjin nr. 8091, datë 21.3.1996", të ardhurat e realizuara nga shitja e pasurive të paluajtshme, me vlerë deri në 2 milionë lekë, nuk tatohen. Ndërkohë, detyrimi për pagimin e tatimit në masën 0,5% të çmimit të shitjes në rastin e kalimit të pronësisë së pasurive të paluajtshme që shiten me vlerë deri në 2.000.000 lekë, është miratuar me ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, i cili ka hyrë në fuqi në janar të vitit 1999. Për rrjedhojë, Komisioni me të drejtë ka arritur në konkluzionin që për të ardhurat e krijuara nga këto dy pasuri të paluajtshme, përkatësisht në periudhën nëntor 1997 dhe gusht 1998, subjekti i rivlerësimit nuk ishte subjekt i detyrimit tatimor për tatimin mbi të ardhurat personale nga kalimi i pasurisë së paluajtshme, për sa kohë vlera e shitjes së pasurisë, në secilin rast nuk e kalonte vlerën prej 2.000.000 lekësh.

41.3. Në vijim të këtij konkluzioni, Komisioni do duhej t'i kishte përfshirë këto të ardhura të ligjshme në analizën financiare për verifikimin e mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për krijimin e pasurive të paluajtshme, sipas kontratës së sipërmarrjes. Për rrjedhojë, pretendimi i subjektit të rivlerësimit lidhur me sa më sipër, gjendet i drejtë.

41.4. Sa i takon pretendimit të subjektit të rivlerësimit, sipas të cilit analiza financiare e Komisionit duhet të ishte shtrirë deri në fund të vitit 1999 kur dhe janë përmbushur detyrimet e pagesës, dhe jo deri në përfundim të vitit 1998, nga vlerësimi i akteve të fashikullit të Komisionit, trupi gjykues konstatoi si më poshtë.

- Subjekti i rivlerësimit, në përgjigjet e dhëna më datë 25.09.2018, lidhur me pyetësonin e Komisionit mbi vlerën e investimit dhe shlyerjen e detyrimeve për shoqërinë ndërtuese, është shprehur: *Vlera e investimit ka qenë 2.500.000 lekë sipas kushteve të kontratës. Detyrimet janë shlyer për periudhën 25.09.1998 - 18.08.1999. Janë përpiluar gjithsej 11 deklarata ose mandatarkëtime (bashkëlidhur). Sipas kushteve të kontratës, kështu e lekëve duhej të paguheshin në emër të financieres S. B., nëpërmjet bankës. Efektivisht lekët i janë dorëzuar kësaj të fundit përkundrejt vërtetimit me shkresë dore (deklaratë ose mandatarkëtim).*
- Komisioni, në analizën financiare për vitin 1998, në rubrikën “pagesë për blerje pasurie¹⁵”, pasurinë neto e ka shprehur me vlerën prej 2.250.000 lekë, duke ia ngarkuar subjektit të rivlerësimit këtë vlerë si shpenzim për vitin 1998, me shpjegimin e shlyerjes së kësteve sipas kontratës së sipërmarrjes.
- Referuar kontratës së sipërmarrjes, çmimi i sipërmarrjes është përcaktuar 20.000 lekë për metër katror, ku sipërfaqja ndërtimore për secilin porositi është 125 m², nga ku rezultoi se çmimi i sipërmarrjes është 2.500.000 lekë. Sa i takon mënyrës së shlyerjes së këtij çmimi, në kontratë është përcaktuar shprehimisht: *Sipas kërkesës së sipërmarrësit, porositisit do të shlyejnë çmimin e caktuar në katër këste dhe konkretisht:*
 - (i) *Kësti i parë, i dytë dhe i tretë do të jenë nga 30%, pra nga 750.000 lekë, ndërsa i fundit 10%, pra 250.000 lekë.*
 - (ii) *Kësti i parë do të paguhet deri më datën 1 tetor 1998 dhe me marrëveshje të palëve, i copëzuar (sipas volumit të punës).*
 - (iii) *Kësti i dytë do të paguhet pasi të ketë përfunduar kati përdhës (garazhet) deri në përfundim të godinës si karabina.*
 - (iv) *Kësti i tretë do të paguhet deri në përfundim të krejt punimeve. Me marrëveshje të palëve, edhe këto këste mund të paguhen të copëzuara dhe në bazë të vëllimit të punës së kryer.*
 - (v) *Kësti i fundit do të paguhet në kohën e marrjes në dorëzim të objektit.*
- Nga vlerësimi i mandatpagesave të përcjella nga subjekti i rivlerësimit, të cilat janë nënshkruar nga ky i fundit dhe znj. S. B., në cilësinë e personit të autorizuar në kontratën e sipërmarrjes për marrjen në dorëzim të shumave, të cilat në total kapin vlerën prej 2.500.000 lekësh (çmimin e sipërmarrjes), konstatohet se po të grupohen sipas periudhave në të cilat do duhet të ishin përmbushur detyrimet e secilit prej kësteve, sipas përshkrimit të tyre në kontratë, rezulton se detyrimet kontraktuale janë përmbushur nga subjekti, sipas mënyrës së parashikuar, konkretisht:
 - (i) *Kësti i parë prej 750.000 lekësh, referuar përshkrimit si më sipër, duhej të ishte paguar deri më datë 1 tetor 1998. Nga verifikimi i mandatpagesave, rezultoi se deri më datë 21.11.1998 subjekti ka paguar 700.000 lekë (pothuajse këstin e parë).*
 - (ii) *Deri më datë 19.05.1999, subjekti ka likuiduar vlerën prej 2.250.000 lekësh, që përkon me shlyerjen e kështit të tretë, i cili në kontratë përcaktohet me afat përfundimin e krejt punimeve (ku referuar nenit të afatit të punimeve kjo periudhë përcaktohet tetor 1998 – maj 1999).*
 - (iii) *Deri më datë 04.08.1999, subjekti ka likuiduar edhe këstin e IV dhe të fundit prej 250.000 lekësh (gjithsej 2.500.000 lekë, çmimin e plotë të sipërmarrjes).*

¹⁵ Shih tabelën e analizës financiare në faqen 10 të vendimit të Komisionit.

41.5. Në vlerësim të sa më sipër, trupi gjykues çmon se Komisioni ka gabuar në interpretimin e fakteve lidhur me zbatimin e kontratës së sipërmarrjes (shlyerjen e kësteve të çmimit të sipërmarrjes) dhe se alokimi i pagesës së tri kësteve të para të çmimit të sipërmarrjes, në vlerën totale prej 2.250.000 lekësh në analizën e vitit 1998, me arsyetimin se vlera e këtyre tri kësteve, referuar kontratës së sipërmarrjes, duhet të paguhej deri në datën 31.12.1998, nuk bazohet në prova. Për rrjedhojë, analizimi i situatës financiare për efekt të vlerësimit të mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për përballimin e shpenzimeve të sipërmarrjes deri më 31.12.1998, nuk përputhet me situatën reale në lidhje me shpenzimet e kryera nga subjekti për krijimin e pasurisë “apartament banimi” me sip. 125 m² dhe garazh dhe, në këtë kuptim, analiza e mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për krijimin e pasurive objekt kontrolli duhet të shtrihet deri në periudhën e pagesës së kështit të fundit me të cilin është likuiduar plotësisht çmimi i sipërmarrjes.

41.6. Në lidhje me pretendimet e subjektit të rivlerësimit për mosmarrjen në konsideratë nga Komisioni të një periudhe punësimi të siguruar prej afro 10 vitesh për subjektin e rivlerësimit dhe bashkëshorten e tij, me pretendimin që për këtë periudhë subjekti nuk paraqiti dokumentacion justifikues për të ardhurat e krijuara, nga shqyrtimi i akteve të fashikullit të Komisionit, konstatohet se:

- a) Subjekti ka deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting*, në rubrikën e përshkrimit të të ardhurave, ndër të tjera:
 - *Të ardhura nga paga si përmbaryes gjyqësor/Gjykata Përmet për periudhën 01.10.1982 - 08.05.1986. Nuk disponoj dokumentacion për pagën.*
 - *Të ardhura nga paga si gjyqtar në gjykatat respektive Tepelenë, Librazhd për periudhën 08.05.1986 - 01.11.1993. Nuk disponoj dokumentacion për pagën.*
 - *Avokat për periudhën 01.03.1995 - 31.03.1998. Nuk disponoj dokumentacion për pagën.*
- b) Në kuadër të përmbushjes së detyrimit të parashikuar në nenin 32, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar së bashku me deklaratën e pasurisë, dokumentacion justifikues ligjor, si më poshtë.
 - Kopje të librezës së punës¹⁶, nga e cila provohet se deklaratimet e subjektit të rivlerësimit për marrëdhëniet e punës të deklaruara dhe periudhat përkatëse janë të vërteta.
 - Kopje të librezës së kontributeve për sigurimin shoqëror dhe shëndetësor (për të vetëpunësuarit)¹⁷. Nga ky dokument provohet se subjekti i rivlerësimit ka derdhur pranë degës së sigurimeve Librazhd, përkatësisht shumat prej 20400 lekësh për vitin 1996, 24480 lekësh për vitin 1997 dhe 7500 lekësh për tremujorin e parë të vitit 1998.
 - Vërtetim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, datë 26.10.2016, me anë të të cilit vërtetohet se z. Luan Dervishi ka ushtruar detyrën e gjyqtarit pranë Gjykatës së Rrethit Librazhd dhe pranë Gjykatës së Rrethit Elbasan dhe se për periudhën e punës në Gjykatën e Rrethit Librazhd, nuk gjendet dokumentacioni për pagesat e përfituara.

41.7. Në analizë të sa më sipër, trupi gjykues çmon se në rastin në fjalë, subjekti i rivlerësimit ka përmbushur detyrimin e tij të parashikuar nga neni 32, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, për të justifikuar me anë të dokumentacionit vërtetësinë e deklaratimeve të dhëna në deklaratën e pasurisë *vetting* lidhur me punësimin e tij dhe periudhat e deklaruara, duke identifikuar në këtë mënyrë burimet e ligjshme të të ardhurave dhe, për rrjedhojë, duke mundësuar Komisionin të kryente në vijim të gjitha verifikimet e tij lidhur me faktet e pretenduara nga subjekti i rivlerësimit mbi punësimin.

¹⁶ Me nr. regjistri themeltar {***} (fletët me nr. 1, 10-15, të vulosura rregullisht nga qendrat e punës).

¹⁷ Me nr. të sigurimit shoqëror {***} dhe nr. serie {***} (fletët që u takojnë viteve 1996, 1997 dhe 1998, vit në të cilin është plotësuar vetëm 3-mujori i parë).

41.8. Sa i takon nivelit të të ardhurave të krijuara (të cilat subjekti nuk i ka identifikuar as në deklaratën e pasurisë *vetting*), trupi gjykues çmon se mosparaqitja e dokumentacionit justifikues, sa u takon të ardhurave nga puna si gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Librazhd, është për shkaqe të arsyeshme, referuar parashikimeve të nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, për sa kohë subjekti bëri të gjitha përpjekjet e mundshme dhe provoi që dokumentacioni i kërkuar nuk ekzistonte. Në vijim të sa më sipër, në kuadër të arritjes së një vendimi sa më të drejtë, në kushtet kur subjekti provoi burimin e ligjshëm të të ardhurave nga punësimi si gjyqtar, në vlerësim të trupit gjykues Komisioni do duhej të kishte bërë përpjekjet e nevojshme për të përlogaritur të ardhurën nga paga e subjektit pranë Gjykatës së Rrethit Librazhd mbi bazën e pagave të referencës për gjyqtarët, sipas legjislacionit të zbatueshëm të kohës. Kjo e ardhur do duhej të ishte përfshirë në analizën e mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për krijimin e pasurisë apartament me sip. 125 m² dhe garazh, sipas kontratës së sipërmarrjes.

41.9. Ndërsa sa u takon të ardhurave të pretenduara nga aktiviteti i ushtruar si avokat, trupi gjykues çmon se, pavarësisht se subjekti i rivlerësimit arriti të provojë si burim të ligjshëm aktivitetin e ushtruar si avokat, të ardhurat e krijuara nga ky aktivitet, për sa kohë mbetën të paqarta sa i takon nivelit të tyre, nuk sjellin efekt të matshëm në analizën financiare të Komisionit.

42. Nga përlogaritjet e kryera në Kolegj lidhur me përcaktimin e të ardhurave me burim punësimin e subjektit si gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Librazhd, pasqyrimin e të ardhurave të krijuara nga shitja e dy pasurive të paluajtshme, të cilat gabimisht nuk janë përfshirë në analizën e mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme të kryer nga Komisioni, si dhe shtrirjen e kohëzgjatjes së analizës së mësipërme deri në pagesën prej subjektit të këstit të fundit të çmimit të kontratës së sipërmarrjes në gusht të vitit 1999, trupi gjykues konstatoi se rezultati financiar i Komisionit për pamjaftueshmëri të burimeve të ligjshme për krijimin e pasurive të paluajtshme nga kontrata e sipërmarrjes me 1346010 lekë, është i gabuar. Duke qenë se rezultati i Komisionit mbi pamjaftueshmërinë e burimeve të ligjshme të subjektit të rivlerësimit për krijimin e dy pasurive të paluajtshme sipas kontratës së sipërmarrjes u provua të jetë i gabuar, vetëm me përfshirjen e të ardhurave si më sipër trajtuar, trupi gjykues e gjen të panevojshme arsyetimin lidhur me pretendimet e tjera të subjektit të rivlerësimit mbi pagat e papërfshira të bashkëshortes së tij.
43. Në përfundim të analizës së kryer lidhur me vlerësimin e shkakut të ngritur në ankimin e subjektit të rivlerësimit mbi kontrollin e pasurisë së llojit “apartament banimi” me sipërfaqe 125 m², si dhe një garazh me sip. 40 m², ndodhur në rr “{***}”, Tiranë, me vlerë ndërtimi 2.500.000 lekë, trupi gjykues arriti në konkluzionin se subjekti nuk ka kryer deklaram të rremë të këtyre pasurive, por deklaram të pasaktë të burimeve të krijimit të tyre në deklaratën e pasurisë *vetting*, referuar parashikimeve të nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016. Ndryshe nga sa ka vlerësuar Komisioni, subjekti provoi se ka pasur burime të ligjshme të mjaftueshme për krijimin e pasurisë apartament me sip. 125m² dhe garazh, sipas kontratës së sipërmarrjes.
44. *Lidhur me të ardhurat nga qiraja e apartamentit me sipërfaqe 125 m² dhe e garazhit me adresë në rrugën “{***}”, për vitet 2013, 2014 dhe 2015, për të cilat subjekti i rivlerësimit pretendoi se konkluzioni i Komisionit lidhur me to është i gabuar dhe nuk mbështetet në ligj, trupi gjykues konstatoi sa vijon.*
45. Komisioni, në përfundim të procesit të rivlerësimit, ka arsyetuar në vendimin e tij lidhur me krijimin e këtyre të ardhurave: *Subjekti i rivlerësimit ka mospërputhje të vlerës së përfutur të qirasë referuar deklarimeve të viteve 2014 dhe 2015 me kontratën e qirasë që ka paraqitur. Për sa më sipër, Komisioni arsyeton se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të rremë. Subjekti i*

*rivlerësimit nuk arriti të provojë të kundërtën e shkresës nr. {***} prot., datë 26.09.2018, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, e cila konfirmon se individ Luan Dervishi, nga të dhënat e kontabilitetit ndër vite nuk ka të deklaruar dhe paguar tatimin mbi qiranë. Lidhur nga sa më lart, Komisioni arsyeton se shuma e përfituar, prej 1.100.000 lekësh, nga subjekti nuk konsiderohet e ardhur e ligjshme në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.*

Subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur në mënyrë të saktë të ardhurat e përfituara nga qiraja gjatë vitit 2015. Në këto kushte, Komisioni arsyeton se subjekti i rivlerësimit ka kryer fshehje të të ardhurave me qëllim që t'i shmangej pagimit të detyrimeve tatimore.

[...] Komisioni arsyeton se mandatet e “Raiffeisen Bank” (2 copë), me përshkrimin derdhje për tatim taksa pa deklaratë tatimore, nuk konsiderohen provë pasi banka luan vetë rolin e agjentit për të paguar tatimet, por nuk vërteton se ato janë paguar. Subjekti i rivlerësimit duhet të merrte një vërtetim nga Drejtoria e Përgjithshme dhe/ose Rajonale Tatimore për të vërtetuar që tatimet ishin paguar.

46. Subjekti i rivlerësimit, në kuadër të kundërshtimit të vlerësimit që Komisioni u ka bërë të ardhurave të krijuara nga dhënia me qira e apartamentit dhe garazheve, ka ngritur shkaqet e mëposhtme në ankimin e tij.

46.1. Subjekti pretendoi se Komisioni ka gabuar në moskonsiderimin si të ligjshme të të ardhurave nga qiraja e apartamentit për vitet 2013 dhe 2014, me arsyetimin se për to nuk është paguar tatimi përkatës, pasi ky konkluzion nuk mbështetet në prova.

46.2. Konkluzioni i Komisionit për deklarim të rremë, si pasojë e mospërputhjes së vlerës së përfituar të qirasë, referuar deklarimeve të viteve 2014 dhe 2015 dhe kontratës së qirasë, është i pabazuar. Gjithashtu, sipas subjektit të rivlerësimit, përfundimi i Komisionit se subjekti nuk ka paguar tatimet ndër vite, referuar përmbajtjes së shkresës së organit tatimor, mbetet një hamendje, për sa kohë nuk janë përcaktuar shprehimisht vitet për të cilat nuk është paguar detyrimi tatimor.

47. Në vlerësim të shkaqeve të mësipërme të ankimit, nga shqyrtimi i dokumentacionit të fashikullit të Komisionit, trupi gjykues vëren se:

- Në vitin 2013 dhe në vitin 2014, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në DIVPP-të përkatëse të ardhura nga dhënia me qira e apartamentit dhe e garazheve në vlerën prej 550.000 lekësh për secilin vit.

- Subjekti i rivlerësimit ka lidhur kontratë qiraje me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 01.07.2014, para noterit L. D., me objekt qiraje apartamentin e banimit me sip. 125 m² dhe vend parkimin, me afat 1 vit, nga data 01.07.2014 - 01.07.2015, me çmim mujor të kontratës 31.000 lekë në muaj. Sipas nenit 3.2 të kontratës, pagesa e çmimit të qirasë do të bëhet parapagim të qiradhënësi në momentin e nënshkrimit të kësaj kontrate për gjithë periudhën e qirasë në masën 372.000 lekë.

- Për periudhën nga janari i vitit 2013 dhe deri në qershor të vitit 2014, subjekti i rivlerësimit pretendon se ka pasur marrëdhënie qiraje me grupe studentësh, por jo të materializuara në formë shkresore.

- Lidhur me të ardhurat e deklaruara nga qiraja për vitet 2013 dhe 2014, subjekti i rivlerësimit rezultoi se ka paguar:

- (i) tatimin mbi të ardhurat nga qiraja për vitin 2013, më datë 14.12.2013, në vlerën prej 60.000 lekësh, pranë Bankës Raiffeisen, sipas mandatpagesës me titull “Derdhje për Tatim Taksa (pa deklaratë tatimore)”, me urdhërues “Luan Dervishi M.”, me përfitues “Dega e Tatimeve Tiranë me nr. llogarie {***}”; dhe

(ii) tatimin mbi të ardhurat nga qiraja për vitin 2014, më datë 17.12.2014, në vlerën prej 60.000 lekësh, pranë Bankës Raiffeisen, sipas mandatpagesës me titull “Derdhje për Tatim Taksa (pa deklaratë tatimore)”, me urdhërues “Luan Dervishi M.”, me përfitues “Dega e Tatimeve Tiranë me nr. llogarie {***}”.

48. Në vlerësim të rrethanave të faktit të sipërcituara, si dhe në referencë të parashikimeve të nenit 803 të Kodit Civil, sipas të cilit kontrata e qirasë duhet bërë me shkresë kur lidhet për një afat kohor më të gjatë se një vit, trupi gjykues vlerësoi si të provuar ekzistencën e marrëdhënies së qirasë për periudhën e vitit 2013, sipas deklaratës të subjektit për periudha kohore të shkurtra, por të pakonfirmuara, dhe të ardhurat e krijuara si pasojë e kësaj marrëdhënieje, pavarësisht mungesës së dokumentacionit shkresor, në vlerën që i korrespondon të ardhurës bruto, mbi të cilën është vlerësuar dhe paguar në favor të organit tatimor detyrimi përkatës tatimor. Të njëjtin qëndrim trupi gjykues mbajti edhe për qiradhëniet e pretenduara nga subjekti i rivlerësimit, gjatë periudhës 01.01.2014 - 01.07.2014, duke qenë se tatimi prej 60.000 lekësh i paguar për këtë vit kalendarik nga subjekti i rivlerësimit, tejkalon vlerën e tatimit që i korrespondon pagesës së qirasë së marrë sipas kontratës noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 01.07.2014.
49. Sa i takon çështjes lidhur me vlerën provuese të mandatpagesave pranë Bankës Raiffeisen, në kuadër të përmbushjes së detyrimit të subjektit për të paguar tatimin mbi të ardhurat me burim qiradhënien e pasurisë së paluajtshme dhe mospërputhjes së këtyre mandateve me përmbajtjen e shkresës nr. {***} prot., datë 26.09.2018, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, sipas së cilës konfirmohet se individi Luan Dervishi, nga të dhënat e kontabilitetit ndër vite, nuk ka të deklaruar dhe paguar tatimin mbi qiranë, trupi gjykues vlerësoi fillimisht se Komisioni nuk ka bërë hetime të mjaftueshme për të verifikuar me organin tatimor pagesën e kryer nga subjekti i rivlerësimit në favor të organit tatimor, në kushtet kur Komisioni kishte të dhëna të mjaftueshme për të hetuar mbi destinacionin final të pagesës së kryer nga subjekti i rivlerësimit në fundvitet 2013 dhe 2014 pranë Bankës Raiffeisen.
50. Megjithatë, edhe pse konstatohet se veprimi i subjektit të rivlerësimit në pagesën e tatimit mbi të ardhurën nga qiraja për vitet 2013 dhe 2014 nuk është kryer sipas procedurës së parashikuar nga legjislacioni tatimor (subjekti duhej fillimisht të deklaronte pranë organit tatimor vlerën e të ardhurës së krijuar dhe, në vijim, të kryente pagesën e detyrimit përkatës tatimor sipas afateve të përcaktuara në aktet nënligjore përkatëse), sa u takon nevojave të procesit të rivlerësimit, subjekti i rivlerësimit vlerësohet nga trupi gjykues se e ka përmbushur detyrimin ligjor për të paguar tatimin e vendosur me ligjin mbi tatimin për të ardhurat, për ato të ardhura që ai ka realizuar me burim dhënien me qira të pasurive të tij të paluajtshme.
51. Në këtë kuptim, pavarësisht faktit nëse pagesa është derdhur në llogarinë e organit tatimor nga banka, që në rastin në fjalë, sipas arsyetimit të Komisionit, ka vepruar si agjent tatim mbledhës, detyrimi i subjektit të rivlerësimit, në kuadër të parashikimeve të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 30 të ligjit nr. 84/2016, vlerësohet i përmbushur dhe, për pasojë, këto të ardhura duhet të ishin vlerësuar nga ana e Komisionit si të ardhura të ligjshme. Arsyetimi i Komisionit, sipas së cilit, subjekti i rivlerësimit duhet të merrte një vërtetim nga Drejtoria e Përgjithshme dhe/ose Rajonale Tatimore për të vërtetuar që tatimet ishin paguar, është i pabazuar në ligj, për më tepër që referuar dy mandateve si më sipër cituar, pagesa është urdhëruar nga subjekti i rivlerësimit (dhe logjikisht duhet të ketë kaluar) direkt në llogarinë e degës së tatimeve Tiranë.
52. Sa i takon arsyetimit të Komisionit mbi mosparaqitjen në mënyrë të saktë të të ardhurave të përfituara nga qiraja për vitin 2015, çka në vlerësim të Komisionit, subjekti ka kryer fshehje të të ardhurave me qëllim shmangien nga detyrimi për të paguar tatim mbi to, trupi gjykues, duke

marrë shkas nga fakti se të ardhurat e qirasë, sipas kontratës së qirasë me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 01.07.2014, janë parapaguar dhe subjekti i ka përfituar këto të ardhura brenda vitit 2014, vlerëson se ato me të drejtë nuk janë rideklaruar në vitin 2015. Për rrjedhojë, në vijim edhe të konkluzionit të arritur në paragrafin pararendës, trupi gjykues çmon se konkluzioni i Komisionit, sipas të cilit subjekti ka fshehur të ardhurat nga qiraja në vitin 2015, duke iu referuar të ardhurave sipas kontratës së sipërcituar të qirasë, gjendet i gabuar dhe i pabazuar në fakte. Për këto të ardhura, të cilat janë deklaruar në DIPPV-në e vitit 2014, janë paguar edhe detyrimet tatimore përkatëse në datën 17.12.2014, sipas mandatpagesës së sipërcituar.

53. *Lidhur me konkluzionin e Komisionit mbi shitjen me kusht dhe rezervë të apartamentit të banimit, me sipërfaqe 125 m² dhe garazh me sip. 40 m², me adresë në rrugën “{***}”, pallati {***}, hyrja {***}, ap. {***}, Tiranë, të cilin subjekti i rivlerësimi e kundërshtoi si të pabazuar, trupi gjykues konstatoi sa vijon.*
54. Komisioni, në përfundim të procesit të rivlerësimit, ka arsyetuar në vendimin e tij lidhur me shitblerjen e këtyre dy pasurive të paluajtshme:
Subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur në mënyrë të saktë pasurinë në posedim të tij dhe ka kryer deklaram të rremë për shkak se:
- i. Kontrata e shitjes së pasurisë së paluajtshme (me kusht dhe rezervë) nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 06.02.2016, nuk është respektuar nga palët kontraktuese në kushtet thelbësore të saj, si pagimi i kësteve brenda afatit dhe plotësimi i kushtit sipas kontratës.*
 - ii. Palët kanë vepruar ndryshe nga sa është përcaktuar në kontratë, pa bërë amendimin e kontratës së shitjes me kusht dhe rezervë, siç e pranon dhe vetë subjekti.*
 - iii. Në qershor 2018, palët ndryshojnë kushtet thelbësore të kontratës si çmimin, afatin e shlyerjes së kësteve, si dhe objektin e kontratës.*
Bazuar në sa më sipër, Komisioni krijon bindjen se shitja e këtij apartamenti nuk ka ndodhur de facto, por vetëm de jure. Subjekti i rivlerësimit nuk mundi të provojë se kushtet e kontratës ishin respektuar, përkundrazi pranoi se ato janë shkelur nga palët, si dhe pranoi që kushtet thelbësore të kësaj kontrate janë ndryshuar midis palëve në qershor të vitit 2018.
55. Subjekti i rivlerësimit, në kuadër të kundërshtimit të vlerësimit që Komisioni i ka bërë shitblerjes së këtyre pasurive të paluajtshme, ka ngritur shkaqet e mëposhtme në ankimin e tij.
- 55.1. Komisioni ka arritur në konkluzion të gabuar dhe të pambështetur në ligj lidhur me shitjen e kësaj pasurie të paluajtshme. Sipas tij, Komisioni ka gabuar në arritjen e përfundimit se është kryer deklaram i rremë nga ana e subjektit lidhur me shitblerjen e kësaj pasurie të paluajtshme, vetëm për faktin se kontrata e shitblerjes nuk është zbatuar rregullisht nga palët sipas kushteve të saj.
- 55.2. Subjekti pretendoi si të gabuar edhe konkluzionin tjetër të Komisionit lidhur me shitjen e kësaj pasurie, sipas të cilit, si pasojë e faktit se dy pagesat e para për shlyerjen e kësteve të blerjes së apartamentit janë kryer nga z. N. D, në cilësinë e administratorit të një shoqërie tjetër, deklarimi i kryer nga subjekti i rivlerësimit është deklaram i rremë. Sipas subjektit të rivlerësimit, një veprim i tillë, i kryer nga personat e përfshirë, është një veprim i parashikuar nga legjislacioni në fuqi dhe, për më tepër, është kryer me pëlqimin e palëve.
56. Në vlerësim të shkaqeve të ankimit të parashtruara në paragrafin e mësipërm dhe arsyetimit të dhënë nga Komisioni, lidhur me shitblerjen e kësaj pasurie të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues fillimisht çmon me rëndësi përcaktimin e relevancës që paraqet në procesin e rivlerësimit kalimtar marrëdhënia e krijuar mes subjektit të rivlerësimit dhe palës blerëse në

kontratën e shitjes së pasurisë së paluajtshme (me kusht dhe rezervë) nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 06.02.2016, në prani të noterit L. D..

57. Për efekt të analizës së mësipërme, nga verifikimi i akteve të fashikullit, trupi gjykues konstatoi si vijon.
- a) Në datën 06.02.2016, me anë të kontratës noteriale të shitjes së pasurisë së paluajtshme (me kusht dhe rezervë), subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e palës shitëse, dhe shoqëria tregtare “{***}” ShPK, e përfaqësuar nga administratori N. D., kanë rënë dakord për shitjen e pasurisë së paluajtshme të llojit apartament me sip. 125 m², në rrugën “{***}”, ndërtesa {***}, hyrja {***}, ap. {***} Tiranë, me çmim 112.000 euro, në të cilin përfshihen dhe orenditë shtëpiake. Kjo kontratë është lidhur me kushtin e realizimit të legalizimit të objektit pranë ALUIZNI-t dhe regjistrimit të apartamentit pranë ZVRPP Tiranë, gjithashtu dhe me rezervën e ruajtjes së “pronësisë” deri në pagesën e gjithë çmimit të blerjes nga blerësi.
- b) Referuar lëvizjes së llogarisë së subjektit të rivlerësimit pranë Bankës Raiffeisen, në monedhën euro, u konstatua se të gjitha pagesat e kryera në zbatim të kontratës së shitblerjes “me kusht dhe rezervë”, përveç një shume prej 6568 eurosh, e cila është sekuestruar nga përmbauesi privat në kuadër të ekzekutimit të një vendimi gjyqësor, janë gjendje në llogarinë bankare të subjektit të rivlerësimit, në datën 17.08.2018, në totalin prej 72.834 eurosh, të patërhequra prej tij.
58. Në vlerësim të fakteve dhe rrethanave të sipërcituara, trupi gjykues arriti në përfundimin që kjo marrëdhënie shitblerjeje “me kusht dhe rezervë” nuk ka sjellë asnjë ndryshim në gjendjen pasurore të subjektit të rivlerësimit dhe se ky transaksion me këtë pasuri të paluajtshme, krijimi i së cilës është kontrolluar më parë nga Komisioni, e lë subjektin e rivlerësimit në të njëjtën situatë financiare dhe po ashtu në të njëjtat raporte të drejtash pronësore me apartamentin me sip. 125 m². Për rrjedhojë, analiza e hollësishme e Komisionit lidhur me mënyrën e ekzekutimit të kontratës së shitblerjes “me kusht dhe rezervë” nga palët kontraktore, shihet e panevojshme, pasi ky transaksion, për nga rrethanat që e karakterizojnë, nuk sjell asnjë ndikim në procesin e rivlerësimit, sa i takon kriterit të kontrollit të pasurisë.
59. Sa i takon çështjes së deklaramit të subjektit lidhur me këtë pasuri në deklaratën e pasurisë *vetting*, nga shqyrtimi i saj rezulton se subjekti ka deklaruar: *Në bazë të aktit “Kontratë shitje e pasurisë së paluajtshme” (me kusht dhe me rezervë) nr. {***} rep., nr. {***} kol., dt. 06.02.2016, objekti shtëpi banimi prej 125 m² i është shitur subjektit “{***}” ShPK. Transaksionet u kryen në Bankën Raiffeisen, deri në datën 05.01.2017 është derdhur kësti prej 20.000 eurosh (shuma e patërhequr, gjendje në bankë); pjesë takuese 50%. Referuar sa më sipër, trupi gjykues konstatoi se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në mënyrë të saktë raportin e tij me këtë pasuri në momentin e deklaramit, sikundër dhe faktet lidhur me këtë marrëdhënie shitblerjeje me “kusht dhe rezervë” dhe, për rrjedhojë, konkluzioni i Komisionit se subjekti nuk ka deklaruar në mënyrë të saktë pasurinë në posedim të tij dhe ka kryer deklaramit të rremë, është i pambështetur në prova. Trupi gjykues gjen me vend të theksojë se sa i takon çështjes së vlerësimit të saktësisë dhe plotësisë së deklaramit, subjektet e rivlerësimit nuk mund të ngarkohen me përgjegjësinë e deklarimeve të pasakta e aq më pak të deklarimeve të rreme, në kuadër të vlerësimit të fakteve që mund të kenë ndodhur pas datës së deklaramit. Një qëndrim i tillë i Komisionit është i papranueshëm, pasi saktësia dhe vërtetësia e deklaramit të subjekteve të rivlerësimit në kuadër të këtij procesi, si një ndër dy elementet e vlerësimit të kriterit të pasurisë duhet të shqyrtohet dhe vlerësohet vetëm në raport me fakte të cilat kanë ndodhur përpara datës së deklaramit dhe kanë qenë në dijeni të subjekteve në momentin e plotësisë së deklaramit,*

moment ky që në mungesë të fakteve që provojnë të kundërtën, prezumohet të jetë data e dorëzimit të deklaratës së pasurisë *vetting* pranë ILDKPKI-së.

60. Në përfundim të sa më sipër, trupi gjykues e gjen të drejtë dhe të bazuar shkakun e ngritur në ankim se konkluzioni i Komisionit për deklarim të pasaktë dhe të rremë lidhur me shitjen me “kusht dhe rezervë” të apartamentit të banimit në rrugën “{***}”, është i gabuar.

61. Në lidhje me garazhin me sip. 20 m², për të cilin subjekti kundërshtoi si të pabazuar konkluzionin e Komisionit për fshehje dhe paraqitje të pasaktë të numrit dhe të sipërfaqes së garazheve në posedim, trupi gjykues konstatoi si vijon.

62. Komisioni, në përfundim të procesit të rivlerësimit, ka arsyetuar në vendimin e tij lidhur me pasurinë e paluajtshme “garazh”¹⁸ me sip. 20 m² dhe numrin e garazheve që posedon subjekti i rivlerësimit, si më poshtë.

Subjekti i rivlerësimit ka fshehur numrin dhe sipërfaqen e saktë të garazheve në posedim. Ai nuk arriti të provojë bindshëm të kundërtën e rezultateve të hetimit. Nga sa me sipër, Komisioni arsyeton se subjekti i rivlerësimit ka fshehur dhe paraqitur në mënyrë të pasaktë pasuritë në posedim, me qëllim që të fshihte burimin e krijimit të tyre. Lidhur me shpjegimet e dhëna nga ana e subjektit të rivlerësimit, si më lart, Komisioni arsyeton se ato janë konfuze dhe të paqarta dhe nuk shpjegojnë mospërputhjet e konstatuara.

63. Subjekti i rivlerësimit, në kuadër të kundërshtimit të vlerësimit që Komisioni i ka bërë krijimit të pasurive të paluajtshme të llojit “garazh”, ka ngritur shkaqet e mëposhtme në ankimin e tij.

63.1. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se nuk ka fshehur sipërfaqet e garazheve pasi ai nuk i ka ditur ato. Sipas tij, ato nuk janë matur ndonjëherë, pasi nuk ka qenë e nevojshme, fakt ky që, referuar subjektit, rezulton edhe nga përmbajtja e kontratës së sipërmarrjes dhe gjithë akteve të tjera që kanë pasuar këtë dokument. Subjekti pretendoi se lidhur me këtë çështje, ka dhënë të gjitha sqarimet e mundshme pranë Komisionit dhe se ky i fundit, paqartësinë lidhur me numrin e garazheve dhe vlerësimin e shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit mbi to, mund t’i verifikonte në vend, nëpërmjet këqyrjes apo matjes së tyre nga një ekspert i caktuar prej tij, praktikë që e ka aplikuar më parë dhe është e mbështetur në ligj.

63.2. Sa i takon çështjes së burimit të të ardhurave lidhur me blerjen e këtyre garazheve, subjekti i rivlerësimit deklaroi se u qëndron të gjitha deklarimeve të mëparshme që lidhen me çështjen e krijimit të pasurive të paluajtshme sipas kontratës së sipërmarrjes, duke kërkuar në këtë drejtim përllogaritjen e pagave të tij dhe të bashkëshortes deri në vitin 2000, kur dhe është përfunduar shlyerja e pagesave të garazhit. Gjithashtu, subjekti, në drejtim të ekzistencës së burimeve të mjaftueshme për krijimin e këtyre pasurive, pretendoi se ka pasur të ardhura të kënaqshme para vitit 1998, dhe në këtë drejtim paraqet si rrethana bindëse, për të provuar këtë fakt të pretenduar, ekzistencën e depozitave bankare në shumën prej 900.000 lekësh dhe likuiditetet gjendje *cash* në vlerën prej 1.000.000 lekësh.

64. Në vlerësim të shkaqeve të ankimit lidhur me çështjen e garazheve, trupi gjykues çmoi të nevojshëm shqyrtimin e dokumentacionit ligjor i cili ka shërbyer për krijimin/fitimin e pasurive të llojit “garazhe” në godinën 5-katëshe, të ndërtuar sipas kontratës së sipërmarrjes, për të vlerësuar në vijim nëse mospërputhjet që me të drejtë Komisioni, gjatë hetimit të tij, ka

¹⁸ Kaluar në pronësi të subjektit të rivlerësimit me deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 11.03.2000, në prani të noterit F. Z..

konstatuar në deklaratimet e subjektit ndër vite dhe atë të pasurisë *vetting*, janë mospërputhje të cilat të çojnë në situatën e deklaratimit të pamjaftueshëm lidhur me këtë pasuri.

65. Referuar akteve të fashikullit të Komisionit, konkretisht: (i) kontratës së sipërmarrjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 25 shtator 1998, përpara noteres N. K.; (ii) procesverbalit të datës 16.03.1999, të nënshkruar nga të gjithë porositësit e kontratës së sipërmarrjes së sipërcituar dhe sipërmarrësi M.L.; dhe (iii) deklaratës noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 11.03.2000, në prani të noterit F. Z. – trupi gjykues, pas shqyrtoi hollësisht përmbajtjet e këtyre akteve ligjore, konstatoi se në asnjë prej këtyre akteve, të cilat lidhen me origjinën e garazheve në posedim/pronësi të subjektit të rivlerësimit, ato nuk përcaktohen me sipërfaqe konkrete. E vetmja përlllogaritje e cila mund të kryhet dhe mund të japë në mënyrë indirekte sipërfaqen, është ajo lidhur me dy garazhet me nr. 2 dhe sipërfaqet e tepërta të dy garazheve me nr. 0, që në total rezultojnë me sip. 50 m², çka logjikisht do të nënkuptonte që një prej garazheve me nr. 2 dhe sipërfaqja e tepërt e një prej garazheve me nr. 0, së bashku kanë një sipërfaqe në total prej 25 m², nëse gjithmonë garazhet janë me përmasa të njëjta. Ndërsa, sa i takon garazhit nr. 0, të cilin subjekti e ka përfituar në çmimin e kontratës së sipërmarrjes, ai nuk është identifikuar në asnjë prej akteve të sipërcituara, sikundër dhe nuk rezulton asnjë e dhënë që mund ta çonte trupin gjykues në identifikimin e sipërfaqes së tij. Për rrjedhojë, trupi gjykues arriti në përfundimin se pretendimi i subjektit se nuk i ka ditur sipërfaqet e garazheve dhe se ato nuk janë matur ndonjëherë, pasi nuk ka qenë e nevojshme, është i besueshëm.
66. Sqarimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit në përgjigjet e pyetësorit, janë në përputhje me përcaktimet në aktet e trajtuara më sipër, për rrjedhojë Komisioni duhet t'i kishte vlerësuar ato si shpjegime bindëse dhe mospërputhjet në deklaratimin herë 2 dhe herë 3 garazhe, si pasaktësi të cilat rrjedhin nga planvendosja e garazheve në pronësi/posedim të subjektit të rivlerësimit dhe pa efekt në vlerësimin e saktësisë dhe vërtetësisë së deklaratimit të subjektit, lidhur me këtë pasuri objekt kontrolli. Për rrjedhojë, përfundimi i arritur nga Komisioni për paraqitje të pasaktë të pasurisë në posedim, me pasojë fshehjen, gjendet i gabuar dhe i pambështetur në faktet e provuara gjatë hetimit administrativ në Komision.
67. Për më tepër, trupi gjykues çmoi të nevojshme edhe verifikimin nëpërmjet Njësisë së Shërbimit Ligjor të mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme të subjektit të rivlerësimit për blerjen e këtyre garazheve, sipas deklaratës noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 11.03.2000, nga ku arriti në përfundimin se subjekti ka pasur burime të ligjshme të mjaftueshme për blerjen e kryer sipas deklaratës së sipërcituar noteriale.
68. Në përfundim, trupi gjykues i gjeti të drejta dhe të bazuara shkaqet e ngritura në ankim lidhur me vlerësimin e konkluzionit të arritur nga Komisioni për pasurinë e paluajtshme “garazh” me sip. 20 m².
69. *Lidhur me shkakun e ngritur në ankim për vlerësimin e depozitës së krijuar në vitin 2009 pranë Credins Bank, e cila në momentin e deklaratimit në deklaratën e pasurisë vetting paraqet gjendje shumë prej 1452.532,06 lekësh*, sipas të cilit subjekti i rivlerësimit pretendoi se konkluzioni i Komisionit për deklarim të rremë të kësaj pasurie është i pabazuar. Nga shqyrtimi i këtij shkak u ankimi, trupi gjykues vëren:
70. Komisioni në vendimin e tij ka arsyetuar lidhur me deklaratimin nga ana e subjektit të rivlerësimit të kësaj pasurie në formën e likuiditetit “depozitë bankare”: *Komisioni, pasi shqyrtoi dhe analizoi shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit dhe deklaratimet e bëra në seancë dëgjimore arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të shpjegojë bindshëm*

mospërputhjet që ekzistonin në lidhje me burimin e krijimit të kësaj depozite. Për sa më lart, Komisioni del në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të rremë në lidhje me burimin e krijimit të kësaj depozite në deklaratën “vetting” të vitit 2017. Lidhur me shpjegimet e dhëna nga ana e subjektit të rivlerësimit, Komisioni arsyeton se ato nuk qartësuan mospërputhjet e krijimit të kësaj depozite.

71. Subjekti i rivlerësimit, në mbështetje të shkakut të ngritur në ankim, parashtroi se i përmbahet qëndrimit të dhënë më parë në Komision, duke deklaruar se: [...] *Tërheqja e depozitës (vlerës) prej 1946.600 lekësh, në datën 05.03.2009, përbën edhe veprimin e fundit të mbylljes së kësaj depozite pranë “Raiffeisen Bank”. Një pjesë e shumës prej rreth 1.000.000 lekësh ka shërbyer për hapjen e një depozite të re pranë “Credins Bank” (datë 08.09.2009), ndërkaq pjesa tjetër [....]”.*
72. Në kuadër të shqyrtimit të shkakut të mësipërm të ankimit të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues konstatoi se:
- (i) Në DIPPV-në e vitit 2009, vit në të cilin është deklaruar krijimi i kësaj depozite, subjekti ka deklaruar si burim për krijimin e saj: *nga kalimi i gjendjes cash, të deklaruar për periudhën 2003-2009.*
 - (ii) Në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti ka deklaruar burimin e krijimit: *të ardhura nga puna.*
 - (iii) Nga verifikimi i kryer lidhur me gjendjen e llogarive bankare të subjektit të rivlerësimit dhe më konkretisht, sa i takon depozitës pranë Bankës Raiffeisen, nga mbyllja e së cilës pretendohet se është krijuar depozita pranë Bankës Credins, u konstatua se depozita pranë Bankës Raiffeisen rezultonte me gjendje në vlerën prej 959.081,38 lekësh, në datën 01.10.2004. Në deklarin për herë të parë në vitin 2003, dorëzuar pranë ILDKPI-së më datë 26.03.2004, subjekti ka deklaruar në rubrikën e likuiditeteve edhe një depozitë në vlerën prej 900.000 lekësh pranë Bankës së Kursimeve¹⁹, me burim “të ardhura nga puna”.
 - (iv) Pas vitit 2004, kjo depozitë tashmë pranë Bankës Raiffeisen rritet me shumën prej 700.000 lekësh në datën 23.02.2007, të cilat kalojnë në depozitë nga llogaria e pagës së subjektit në të njëjtën bankë, me kalim të brendshëm ndërmjet llogarive.
 - (v) Në datën 05.03.2009, subjekti i rivlerësimit, pasi tërheq nga Banka Raiffeisen shumën prej 1.946.600 lekësh, ka depozituar *cash* pranë Bankës Credins, në të njëjtën datë, shumën prej 1.001.000 lekësh, dhe në datë 08.09.2009 e ka transferuar këtë depozitë në vlerën 1.032.336,5 lekësh, në një tjetër depozitë të re (në depozitën e deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting*), e cila ka vazhduar të akumulojë interesa çdo vit, deri në vitin 2016, ku ka arritur vlerën prej 1.452.130,12 lekësh.
73. Në shqyrtim të fakteve të konstatuara si më sipërcituar, trupi gjykues vlerëson se shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, lidhur me origjinën dhe burimet e krijimit të depozitës së sipërcituar, janë në përputhje me faktet e provuara, sipas dokumentacionit të administruar nga ana e Komisionit gjatë procesit të rivlerësimit të tij. Arsyetimi i Komisionit se subjekti nuk arriti të shpjegojë bindshëm mospërputhjet që ekzistonin lidhur me burimin e krijimit të kësaj depozite, gjendet i pabazuar nga ana e trupit gjykues, pasi konstatohet se subjekti i rivlerësimit, në përputhje me parashikimet e pikës 7 të Udhëzimit të Inspektorit të Përgjithshëm të Inspektoratit të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave nr. 4095 prot., datë 10.10.2016, “Për mënyrën e deklarimit të pasurive në pronësi, posedim dhe përdorim, burimet e krijimit të tyre, detyrimet financiare etj., nga subjektet e rivlerësimit dhe personat e

¹⁹ Tani Banka Raiffeisen.

lidhur që mbartin detyrimin për deklarim të pasurisë, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, datë 30.08.2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting* burimin e krijimit të kësaj pasurie të luajtshme në momentin e krijimit, i cili rezulton të jetë punësimi (të ardhurat nga puna). Përshkrimi i dhënë në DIPPV-në e vitit 2009, në formën e burimit të krijimit të depozitës (depozitës së transferuar në datën 08.09.2009), referuar kërkesave lidhur me deklarinimet periodike, sipas nenit 7 të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë” i referohet pasqyrimit të ndryshimeve të likuiditetit nga gjendja *cash* (e akumuluar ndër vite dhe pas tërheqjes së saj, në datën 05.03.2009, me mbylljen e depozitës pranë Bankës Raiffeissen), në depozitë bankare pranë Bankës Credins, por burimi fillestar i krijimit të këtij likuiditeti me të cilin është krijuar pasuria e luajtshme në formën e depozitës bankare pranë Bankës Credins, rezultojnë të jenë të ardhurat e krijuara nga i vetmi burim i deklaruar të ardhurash, ai i punësimit. Për rrjedhojë, trupi gjykues e gjen të drejtë dhe të bazuar shkakun e mësipërm të ankimit të subjektit të rivlerësimit dhe të pabazuar për pasojë konkluzionin e arritur nga Komisioni për deklarim të rremë të kësaj depozite nga ana e subjektit të rivlerësimit.

74. *Lidhur me blerjen e automjetit, tip “Ford Focus*, subjekti i rivlerësimit, në kuadër të kundërshtimit të vlerësimit që Komisioni i ka bërë krijimit të kësaj pasurie të luajtshme në vitin 2011, ka ngritur shkaqet e mëposhtme në ankimin e tij.

74.1. Deklarimi i kësaj pasurie është i saktë dhe në përputhje me ligjin, e vetmja mospërputhje në deklarime lidhur me vlerën e kësaj pasurie i referohet vlerës prej 100 eurosh, që përfaqëson taksën e regjistrimit/qarkullimit, të cilën shitësi e ka paguar për llogari të subjektit dhe kjo nuk ka qenë e përfshirë në çmimin e dakordësuar për shitblerjen e automjetit, çka shpjegon dhe mospërputhjen midis vlerës së faturës dhe kontratës së shitblerjes prej 13.900 eurosh dhe vlerës së deklaruar prej 14.000 eurosh.

74.2. Subjekti kundërshtoi konkluzionin e Komisionit për deklarim të rremë të mënyrës së shlyerjes së çmimit të automjetit dhe argumentoi se mënyra e ekzekutimit të kushteve të kontratës (në një apo dy këste) është çështje që lidhet me vullnetin e palëve dhe nuk mund të vlerësohet si shkelje apo deklarim i rremë.

74.3. Lidhur me konkluzionin e Komisionit për fshehjen e huas nga z. B. Ç. në deklaratën e pasurisë *vetting* dhe mungesën e burimeve financiare të ligjshme për blerjen e automjetit, subjekti i rivlerësimit i kundërshtoi këto konkluzione si të pabazuara, duke qenë se, sipas tij:

- (i) Huan që subjekti i rivlerësimit i ka marrë kunatit, z. B. Ç., e ka përpiluar me akt noterial dhe e ka deklaruar këtë fakt në deklarimin periodik të vitit 2011, si dhe në vijim ka deklaruar edhe mënyrën e shlyerjes së huas, duke përpiluar në fund edhe një shkresë për këtë qëllim.
- (ii) Sa i takon mjaftueshmërisë së burimeve financiare, subjekti parashtroi se, pavarësisht faktit se për blerjen e automjetit ka marrë hua në vlerën 7.000 euro, ai ka pasur burime financiare të mjaftueshme për ta përballuar këtë shpenzim, por për arsye që lidheshin me shkollimin e vajzës së tij në ShBA, ka vlerësuar të mos i përdorë ato. Përlllogaritjet e Komisionit lidhur me analizën financiare për vitin 2011 janë qëllimisht të gabuara, si pasojë e paragjyqimit të procesit.

75. Lidhur me krijimin e kësaj pasurie të luajtshme të subjektit të rivlerësimit në vitin 2011, Komisioni në përfundim të procesit të rivlerësimit ka arsyetuar në vendimin e tij:
Subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të rremë në lidhje me mënyrën e shlyerjes dhe burimin që ka shërbyer për blerjen e këtij automjeti. Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar huan e marrë

nga z. B. Ç. në deklaratën “vetting” si burim i krijimit për automjetin, tip “Ford Focus”, ndërkohë që në deklaratën periodike vjetore të vitit 2011, deklararon se automjetin e ka blerë me një pjesë nga huaja e marrë. Për sa më lart, Komisioni, arsyeton se subjekti ka paraqitur në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi dhe ka kryer deklaram të rremë. Subjekti i rivlerësimit ka mungesë financiare në shumën -1998.185 lekë, në vitin 2011, duke marrë në konsideratë deklaramet e subjektit në deklaratën “vetting”. Komisioni arsyeton se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve të ligjshme financiare me dokumentacion ligjor justifikues për blerjen e automjetit, tip “Ford Focus”, në vitin 2011.

76. Në shqyrtim të shkaqeve të ankimit lidhur me këtë pasuri të luajtshme të subjektit të rivlerësimit, nga verifikimet e kryera me dokumentacionin e fashikullit të Komisionit, konstatohet si më poshtë.
- Më datë 15.02.2011, subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e blerësit, dhe “{***}” ShPK, në cilësinë e shitësit, kanë lidhur një kontratë shitblerjeje me qëllim blerjen nga ana e subjektit të rivlerësimit të një automjeti të tipit “Ford Focus Anniversary”, me çmim prej 13900 eurosh. Në nenin 10 të kësaj kontrate përcaktohet mënyra e pagesës, konkretisht *parapagim në llogari të shitësit në vlerën e 2000 eurove menjëherë me nënshkrimin e kontratës dhe pjesa e mbetur e do të paguhet pas marrjes në dorëzim të automjetit.*
 - Ndërkohë, më datë 12.03.2011, subjekti i rivlerësimit ka lidhur një kontratë huaje me nr. {***} rep., nr. {***}kol., në prani të noterit V. D., me anë të së cilës i ka marrë hua, z. B. Ç., vlerën prej 7000 eurosh.
 - Për pagesën e çmimit të plotë të automjetit, nga pala shitëse është lëshuar fatura tatimore e shitjes me nr. fature {***}, datë 08.06.2011, me vlerë 13900 euro.
 - Lidhur me këto transaksione në DIPPV-në e vitit 2011, subjekti ka deklaruar: *Blerje automjeti “Ford” më datë 10.06.2011; vlera e pasurisë: 14000 euro; burimi i krijimit: s’ka deklaram në rubrikën²⁰ në të cilën është përshkruar shtimi i pasurive të subjektit me këtë pasuri të luajtshme.* Ndërsa në rubrikën “Detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë”, subjekti ka deklaruar: *kontratë huaje në euro për blerje automjeti, akt noterik {***}. D.; vlera 7000 euro; kthimi i huas deri më datë 31.12.2012.*
 - Ndërsa në deklaratën e pasurisë *vetting*, pasuria objekt kontrolli është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit: *automjet Ford Focus; kontratë shitje datë 15.02.2011, me shitës firma “{***}” dhe faturë tatimore nr. {***}, dt. 08.6.2011; vlera e pasurisë: 13900 euro; burimi i krijimit: nga të ardhurat nga puna me bashkëshorten, si dhe kontributi i të ardhurave nga puna e djalit.*
77. Në analizë të sa më sipër, trupi gjykues vlerësoi se konkluzioni i Komisionit se subjekti ka kryer deklaram të rremë lidhur me këtë pasuri, si pasojë e mospërputhjeve lidhur me shlyerjen e çmimit, nuk gjendet i bazuar. Ky fakt për më tepër (mënyra e ekzekutimit të detyrimit kontraktual për pagesën e çmimit), përveç se nuk është objekt deklarami, konstatohet se nuk sjell asnjë pasojë edhe në rezultatin e analizës financiare për vitin në të cilin është krijuar kjo pasuri, në kushtet kur edhe nëse do të ishin kryer dy pagesa pjesore (sipas parashikimit në kontratën e shitblerjes), efektet financiare të tyre do të shtriheshin në të njëjtin vit dhe rezultati, për rrjedhojë, do të mbetej i pandryshuar.
78. Ndërkohë, sa i takon konkluzionit të Komisionit, sipas së cilit deklarami i kësaj pasurie është i rremë, si pasojë e mospërputhjeve lidhur me burimin e krijimit, konstatohet se deklarami në deklaratën e pasurisë *vetting* se kjo pasuri është krijuar me burime nga të ardhurat nga puna me bashkëshorten, si dhe kontributi i të ardhurave nga puna e djalit, përveçse nuk është i plotë, pasi

²⁰ Rubrika “Ndryshimet e interesave privatë dhe pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme”, faqe 3 e DIPPV-së 2011.

në kundërshtim me pikën 7 të udhëzimit nr. 4095, datë 10.10.2016, të Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së nuk përfshin burimin e përdorur në momentin e krijimit të pasurisë, huan e deklaruar në DIPPV-në e vitit 2011, si të marrë nga z. B.Ç. për këtë qëllim, në vlerën prej 7000 eurosh, nuk vlerësohet as i saktë në përputhje me ligjin, për sa kohë si burim për krijimin e saj janë deklaruar edhe të ardhurat nga puna e djalit, fakt ky që rezulton i pavërtetë, referuar DIPPV-së së të njëjtit vit, ku këto të ardhura, të krijuara nga puna e djalit E.D. në ShBA, në vlerën prej 10000 USD, janë deklaruar si shtesë e gjendjes *cash*. Në këto kushte, kur deklarimi i subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë *vetting* provohet se përmban të dhëna të pavërteta, trupi gjykues e gjen të drejtë dhe të bazuar konkluzionin e Komisionit për deklarim të rremë të burimeve të krijimit të kësaj pasurie në deklaratën e pasurisë *vetting*.

79. I drejtë dhe i bazuar u gjet edhe konkluzioni tjetër i Komisionit për mungesë të burimeve të ligjshme për financimin e blerjes së këtij automjeti në vitin 2011 edhe pas kontrollit të ushtruar në Kolegj ndaj analizës financiare të Komisionit për vitin 2011, ku pavarësisht vlerësimit si të hyrë të vlerës së huas prej 7000 eurosh, edhe pse Komisioni me të drejtë ka vlerësuar se subjekti nuk ka përmbushur kërkesat e nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 në drejtim të justifikimit të ligjshmërisë së burimeve të vlerës së dhënë hua, subjekti i rivlerësimit rezultoi me një bilanc negativ në shumën prej 1986.338 lekësh, pasi pretendimet e tij për përdorim të kursimeve të akumuluarra deri në vitin 2011 për mbulimin e nevojave të ekonomisë familjare në drejtim të krijimit të pasurive dhe përballimit të shpenzimeve vjetore, gjenden të pabazuara, për sa kohë subjekti nuk ka deklaruar përdorimin e tyre as në formën e burimit për krijimin e pasurisë së luajtshme automjet tip “Ford Focus” dhe as në trajtën e ndryshimit të gjendjes së likuiditetit në formë *cash* jashtë sistemit bankar.
80. Në përfundim të shqyrtimit të shkaqeve të ngritura në ankim lidhur me krijimin e pasurisë së luajtshme automjet tip “Ford Focus” në vitin 2011, trupi gjykues arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e deklarimit të pamjaftueshëm sipas parashikimeve të nenit 33, pika 5, germat “a”, “b” dhe “ç”, duke qenë se u provua të ketë kryer deklarim të rremë lidhur me burimet e krijimit të kësaj pasurie, si dhe ka qenë në kushtet e pamjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për financimin e blerjes së saj.
81. *Lidhur me blerjen e aksioneve “bono privatizimi” në vitin 2007*, subjekti i rivlerësimit në ankimin e tij, në kuadër të kundërshtimit të vlerësimit që Komisioni i ka bërë krijimit të kësaj pasurie në formën e zotërimit të aksioneve në një shoqëri aksionere, pranoi se ndodhet teorikisht në një situatë konflikti interesi, por deklaroi se vullneti për blerjen e këtyre aksioneve nuk është diktuar nga dëshira për t’u angazhuar në një veprimtari të mirëfilltë biznesi, por ka ardhur si rrjedhojë e statusit të bashkëshortes së tij, si e punësuar pranë kompanisë që po privatizohej. Gjithashtu subjekti i rivlerësimit sqaroi se aksionet e tij në këtë kompani kapin vlerën e vetëm 0,0005% të kapitalit të saj dhe se gjatë periudhës nga 2007 nuk ka marrë asnjë qindarkë nga këto aksione, si dhe se nga 2009 shoqëria aksionere ka pasur bilanc negativ.
82. Komisioni, në përfundim të procesit të rivlerësimit, ka arsyetuar në vendimin e tij lidhur me këtë pasuri të subjektit të rivlerësimit: *Në interpretim të neneve të sipërcituara, rezulton se gjyqtarët në gjykatat e apelit dhe personat e lidhur me ta, nuk mund të lidhin kontrata me institucione publike. Në rastin konkret, gjyqtar është subjekti Luan Dervishi, dhe person i lidhur me subjektin është bashkëshortja L. D., e cila është aksionere me 125.000 lekë/125 aksione, në shoqërinë “{***}” ShA. Një ndalim i tillë është bërë me ligjin nr. 44/2014, datë 24.04.2014, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike, të ndryshuar”. Ky ligj ka hyrë në fuqi më datë 03.06.2014. Pra, sipas ndryshimeve të ligjit, rezulton se çdo kontratë e lidhur me institucione*

publike, nga data 03.06.2014, është në shkelje të ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike, me ndryshimet përkatëse”. [...] Bazuar në sa më lart arsyetoi, Komisioni del në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit, z. Luan Dervishi, është në situatën e konfliktit të interesit.

83. Në shqyrtimin e këtij shkaku ankimi, nga verifikimi i legjislacionit në fuqi lidhur me parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike, trupi gjykues konstatoi që subjekti i rivlerësimit, në momentin e blerjes së këtyre aksioneve në emër të tij dhe të bashkëshortes, në kuadër të të drejtave që i takonin kësaj të fundit si ish-punonjëse e shoqërisë {***}, nuk ka shkelur asnjë dispozitë ligjore lidhur me detyrimin që i buronte subjektit në cilësinë e zyrtarit, për të shmangur rastet e konfliktit të interesave. Me ndryshimet e ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, në vitin 2014, sikundër me të drejtë arsyeton Komisioni, subjekti i rivlerësimit konstatohet se ka qenë në gjendjen e konfliktit të interesave, si pasojë e faktit që shoqëria tregtare pranë së cilës subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij zotërojnë aksione, ka lidhur kontrata me subjekte shtetërore.
84. Megjithatë, referuar parashikimeve të nenit D, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 30 të ligjit nr. 84/2016, të cilat përcaktojnë se objekti i kontrollit të kriterit të pasurisë janë pasuritë e subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me ta, trupi gjykues çmoi që gjendja e konfliktit të interesit, në kontekstin e procesit të rivlerësimit, duhet vlerësuar në raport me lidhjen e saj me pasuritë e subjekteve të rivlerësimit dhe personave të lidhur, ku pasojat juridike të mosjustifikimit të ligjshmërisë së burimeve të pasurive, do të krijohen në ato raste kur këto pasuri janë krijuar si pasojë e gjendjes së konfliktit.
85. Në kontekst të sa më sipër, trupi gjykues arriti në përfundimin se, për sa kohë, referuar rezultateve të hetimit të Komisionit në rastin objekt gjykimi, nuk rezultoi që subjekti i rivlerësimit të ketë krijuar të ardhura apo pasuri si pasojë e kësaj situatë konflikti interesi, vlerësohet se kjo gjendje e konfliktit të interesit nuk mund të përfshihet në objektin e veprimtarisë së nenit 33, pika 5, paragrafi “d” dhe, si pasojë, nuk mund të prodhojë efektet e deklaramentit të pamjaftueshëm sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë, trupi gjykues e gjen të drejtë dhe të bazuar shkakun e ngritur në ankim lidhur me kundërshtimin e konkluzionit të Komisionit, sa u takon aksioneve të blera nga subjekti dhe bashkëshortja e tij në vitin 2007.
86. *Lidhur me kundërshtimin nga subjekti i rivlerësimit të konkluzionit të Komisionit mbi pasurinë e luajtshme të deklaruar në deklaratën e pasurisë vetting në formën e “likuiditetit në gjendje cash” në vlerën prej 1.100.000 lekësh, trupi gjykues konstatoi si më poshtë.*
87. Komisioni, në arsyetimin e tij në vendim lidhur me krijimin e kësaj pasurie nga subjekti i rivlerësimit, është shprehur: *Komisioni, pasi shqyrtoi dhe analizoi shpjegimet e dërguara nga subjekti i rivlerësimit dhe deklaramentet e bëra në seancë dëgjimore, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk shpjegoi bindshëm burimin e krijimit të këtyre të ardhurave të deklaruara në deklaratën “vetting” të vitit 2017, pasi në deklaramentet e tij kishte mospërputhje për burimin e krijimit të këtij likuiditeti. Subjekti i rivlerësimit nuk justifikoi me dokumentacion ligjor provues se djali i subjektit kishte mundësi financiare nga burime të ligjshme për të dërguar shumën prej 10000 USD. Neni D, pika 4 e Aneksit të Kushtetutës parashikon se: “Subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave. Pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore.” Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në mënyrë të pasaktë likuiditetin e tij. Lidhur me pretendimet e subjektit të rivlerësimit se shuma prej 5.000 USD, të kursyera nga djali i tij në ShBA, për vitin 2010, fakt i deklaruar dhe i pasqyruar më parë (në*

deklarimin periodik të vitit 2010), i është dorëzuar atij gjatë periudhës verore 2011, kur djali ka ardhur për të shoqëruar vajzën për studime në ShBA. Ndërkohë shuma prej 5.000 USD të tjerë, i është dorëzuar nga bashkëshortja e subjektit, e cila ka qenë për vizitë në ShBA, në muajin nëntor 2011.

Komisioni, për sa më lart, arsyeton se, pavarësisht se mund ta marrim të mirëqenë se këto para ia ka sjellë djali, por për efekt të ligjit nr. 84/2016, këto të ardhura duhet të jenë të ligjshme, pra të jenë paguar detyrimet tatimore. Subjekti i rivlerësimit nuk provoi ligjshmërinë e këtyre të ardhurave. Në këto kushte, këto të ardhura nuk mund të konsiderohen për efekt të analizës financiare të vitit 2011.

88. Nga shqyrtimi i akteve të fashikullit të Komisionit, sa i takon deklarimit të subjektit të rivlerësimit lidhur me krijimin e kësaj pasurie në deklaratën e pasurisë *vetting* dhe deklarimeve të kryera ndër vite, rezultoi përkatësisht si më poshtë.
- (i) Në deklaratën e pasurisë *vetting* është deklaruar: *Lekë cash deri më datë 31.12.2016, vlera e pasurisë: 1.100.000 lekë; burimi i krijimit: të kursyera nga paga për vitet 2013-2014-2015 deri në datën 31.12.2016, të cilat 1.000.000 lekë, çelur depozitë bankare pranë Credins Bank, datë 09.12.2016, dhe 100.000 lekë cash.*
 - (ii) Në DIPPV-në e vitit 2013 është deklaruar në rubrikën e ndryshimeve të pasurive: *Gjendje cash 200.000 lekë (të rrjedhura nga kursimet ndër vite).*
 - (iii) Në DIPPV-në e vitit 2014 është deklaruar në rubrikën e ndryshimeve të pasurive: *200.000 lekë të ardhura të kursyera gjatë vitit 2014, të depozituara në BKT në dt. 31.12.2014.*
 - (iv) Në DIPPV-në e vitit 2015 është deklaruar në rubrikën e ndryshimeve të pasurive: *400.000 lekë cash të ardhura (kursime për vitet 2013-2014, të deklaruara më parë).*
 - (v) Në DIPPV-në e vitit 2016 është deklaruar në rubrikën e ndryshimeve të pasurive: *Çelur, më datë 20.12.2016, një depozitë bankare pranë Credins Bank 1.000.000 lekë cash, burimi i krijimit: 400.000 kursime të rrjedhura nga vitet 2014-2015 dhe 700.000 lekë kursime nga viti 2016. Lekë cash teprice 100.000 lekë.*
89. Në kuadër të kontrollit të vendimit të Komisionit lidhur me qëndrimin e mbajtur në vlerësimin e kësaj pasurie, trupi gjykues e gjen të paqartë arsyetimin e Komisionit në drejtim të lidhjes që i bën kësaj pasurie dhe të ardhurave të djalit të subjektit në vlerën prej 10.000 USD, të krijuara nga puna në ShBA në vitin 2011 dhe të deklaruara si gjendje *cash* në DIPPV-në e vitit 2011, për sa kohë nuk ka asnjë të dhënë të deklaruar nga ana e subjektit apo të evidentuar gjatë hetimit administrativ që të mund të krijojë një lidhje mes këtyre të ardhurave dhe pasurisë objekt kontrolli, që të mund t'i analizojë ato në cilësinë e burimit të krijimit të kësaj pasurie. Për rrjedhojë, ky konkluzion i Komisionit nuk gjendet i drejtë dhe i bazuar.
90. Në vijim të arsyetimit të mësipërm, nga kontrolli i ushtruar në Kolegj për efekt të krijimit të pasurisë në formën e likuiditetit depozitë në Bankën Credins, në vlerën prej 1.000.000 lekësh, në vitin 2016 dhe deklarimit të saj në deklaratën e pasurisë *vetting*, referuar fakteve të konstatuara më sipër, trupi gjykues vëren se nuk ka paqartësi në lidhje me burimin e krijimit të kësaj pasurie, duke qenë se deklarimet ndër vite të vlerësuara në tërësi, si dhe në raport me deklaratën e pasurisë *vetting*, përputhen. Për rrjedhojë, konkluzioni përfundimtar i Komisionit mbi mospërputhjet në burimet e krijimit të këtij likuiditeti, nuk gjendet i bazuar. Për më tepër, Kolegji çmoi të nevojshme edhe kryerjen e verifikimeve të nevojshme lidhur me mjaftueshmërinë e burimeve të ligjshme për krijimin e kursimeve (të cilat kanë shërbyer për krijimin e kësaj depozite) në vitet e deklaruara më sipër, nga ku rezultoi se subjekti i justifikon ato me burime të ligjshme.

91. Në lidhje me shkakun e ankimit për konkluzion të pabazuar në prova, logjikë dhe fakte nga ana e Komisionit lidhur me përdorimin prej subjektit të rivlerësimit të banesës me sip. 60 m², me vendndodhje në Tiranë, në pronësi të znj. M. Sh. (nëna e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit), trupi gjykues konstatoi si vijon.
92. Komisioni, në përfundim të procesit të rivlerësimit, ka arsyetuar në vendimin e tij lidhur me këtë pasuri të deklaruar në përdorim të subjektit të rivlerësimit: *Komisioni, pasi shqyrtoi dhe analizoi shpjegimet e dërguara nga subjekti i rivlerësimit dhe deklarimet e bëra në seancë dëgjimore, arrin në përfundimin se ka dyshime të arsyeshme se subjekti i rivlerësimit është përpjekur të fshehtë këtë pasuri duke e regjistruar në emër të personit tjetër të lidhur/znj. M. Sh., bazuar në sa më poshtë: 1. Subjekti i rivlerësimit banon te ky apartament prej 7 vitesh pa ndërprerje dhe pa kundërshtim. 2. Administratorët e shoqërisë sipërmarrëse “{***}” ShPK janë të njëjtë me ata që kanë ndërtuar apartamentin tjetër me sipërfaqe prej 125 m² dhe janë persona që kanë lidhje shoqërore me subjektin e rivlerësimit. 3. Znj. M. Sh. jeton në ShBA nga viti 2009 dhe nuk kishte asnjë arsye se përse duhet të blinte një pronë të cilën nuk e jep me qira apo nuk jeton vetë aty. 4. Prokura pa afat që znj. M. Sh. i ka lëshuar vajzës së saj/ znj. L. D. (bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit), më datë 8.10.2012, që ta përfaqësojë atë pranë të gjitha institucioneve administrative për tërheqje, nënshkrim, dorëzim dhe kërkim të çdo lloj dokumenti që lidhet me këtë apartament, të veprojë në emër e për llogari të saj për të lidhur dhe nënshkruar aktin përfundimtar të shitblerjes së pronës, ka të drejtë të aplikojë pranë ZVRPP-së Tiranë, për regjistrimin e kësaj prone, pranë ALUIZNI-t, të lëshimit me qira të pronës duke marrë vlerën e qirasë, caktuar çmimin dhe prishë kontratën. 5. Znj. M. Sh. nuk justifikon ligjshmërinë e krijimit të shumës prej 30.000 eurosh që ka blerë këtë apartament as për vete dhe as për djalin, z. S. Sh. Znj. M. Sh., së bashku me të birin, z. S. Sh., kanë të regjistruar në regjistrin e pasurive të paluajtshme një shtëpi tjetër, apartament me sip. 62,16 m² në bashkëpronësi, e regjistruar pranë ZVRPP-së Tiranë, më datë 28.06.2017, ndërkohë që nuk justifikuan ligjshmërinë e krijimit të shumës prej 30.000 eurosh.*
93. Subjekti i rivlerësimit, në mbështetje të shkakut të ngritur në ankim lidhur me përdorimin prej tij të banesës me sip. 60 m², në pronësi të vjehrrës së tij, pretendoi se dyshimet e Komisionit lidhur me fshehjen e kësaj pasurie mbështeten në hamendësime dhe parashitje në mënyrë të hollësishme se:
- Konkluzioni i Komisionit se administratorët e shoqërisë sipërmarrëse “{***}” ShPK janë persona që kanë lidhje shoqërore me subjektin e rivlerësimit është një konkluzion i pamatur, keqdashës dhe i pabazuar në prova. Subjekti pretendoi se gjatë gjithë procesit të rivlerësimit, në asnjë material, nuk është trajtuar kjo lidhje shoqërore.
 - Konkluzioni i Komisionit se znj. M.Sh. jeton në ShBA nga viti 2009 dhe nuk kishte asnjë arsye se përse duhet të blinte një pronë të cilën nuk e jep me qira apo nuk jeton vetë aty nuk është i bazuar, pasi, sipas subjektit të rivlerësimit, znj. M.Sh. (vjehrra) dhe z. S. Sh. (kunati) kanë jetuar në këtë banesë nga viti 2004 kur është ndërtuar dhe deri në vitin 2009 kur janë larguar për në ShBA. Ky fakt, pretendoi subjekti, mund të provohet nëpërmjet verifikimeve të librezës së ujit dhe energjisë elektrike apo verifikimit të konsumit të këtyre shërbimeve utilitare në qytetin Memaliaj, banesës së znj. M.Sh., në të cilën nënkuptohet nga arsyetimi i Komisionit se mund të ketë jetuar kjo e fundit.
 - Gjithashtu, sipas subjektit të rivlerësimit, në vitin 2004 kur znj. M.Sh. ka blerë apartamentin objekt shqyrtimi, nuk kishte se si të parashikonte që në vitin 2009 ajo dhe djali i saj (kunati i subjektit të rivlerësimit), z. S.Sh., do të largoheshin drejt ShBA-së.
 - Konkluzioni i Komisionit lidhur me këtë pasuri jo vetëm nuk është i bazuar në fakte, prova, apo qoftë edhe dyshime, por mbi të gjitha është arritur në shkelje të së drejtës së tij si subjekt

rivlerësimi për t'u mbrojtur ndaj një pretendimi të tillë, pasi formalisht nuk i është bërë i ditur më parë.

- (v) Komisioni nuk ka marrë në shqyrtim provat e kërkuara lidhur me mundësinë e burimeve financiare të vjehrrës M. Sh. dhe kunatit S. Sh. për të përballuar shpenzimin e blerjes së këtij apartamenti dhe ka arritur në konkluzion të gabuar mbi pamjaftueshmërinë e burimeve të ligjshme të tyre, pa vlerësuar provat e dorëzuara për këtë efekt.
- (vi) Lidhur me dyshimet e ngritura mbi blerjen nga znj. M. Sh. dhe kunati S. Sh. të një tjetër pasurie të paluajtshme në bashkëpronësi dhe të regjistruar pranë ZVRPP Tiranë më datë 28.06.2017, subjekti u shpreh se ky është një argument i Komisionit për të provuar dyshimin e tij dhe është në të drejtën e tij. Megjithatë, subjekti theksoi se kunati i tij në vitin 2018 ka blerë edhe një tjetër pasuri të paluajtshme, shtëpinë në të cilën jeton në Shtetet e Bashkuara të Amerikës në vlerën mbi 500.000 USD, ku mbi 300.000 USD kanë qenë të ardhura të krijuara nga puna e tij. Për rrjedhojë, subjekti shprehet se nuk i di arsyet dhe motivet e blerjes së kësaj banese nga kunati, por logjikisht, sipas tij, një person që blen një shtëpi 500.000 USD nuk e ka të vështirë të blejë dhe një tjetër në vendlindjen e tij, në vlerën prej 30.000 USD.
94. Në shqyrtim të shkakut të mësipërm të ankimit, trupi gjykues, pasi vlerësoi aktet e fashikullit të administruar gjatë hetimit nga Komisioni, pretendimet dhe shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, si dhe qëndrimin e mbajtur nga Komisioni, arriti në konkluzionin që përdorimi i banesës me sip. 60 m² nga subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij, në kuadër të fakteve dhe rrethanave që kanë rezultuar nga hetimi administrativ, ndryshe nga sa ka vlerësuar Komisioni, nuk ngre dyshime për fshehje të kësaj pasurie nga subjekti i rivlerësimit, nëpërmjet regjistrimit të saj në emër të nënës së bashkëshortes së tij, znj. M. Sh..
95. Në arritjen e këtij konkluzioni, trupi gjykues mbajti në konsideratë faktin që, referuar hetimit administrativ, nuk rezultoi asnjë e dhënë në drejtim të vendosjes së një raporti të ngushtë mes subjektit të rivlerësimit/bashkëshortes së tij dhe pasurisë objekt kontrolli, të ngjashme me atë të pronësisë mbi sendin, përveç faktit të përdorimit pa ndërprerje të kësaj pasurie për një periudhë kohore relativisht të gjatë, prej 7 vitesh, fakt ky që në vlerësimin e trupit gjykues, referuar marrëdhënies së posaçme të pronares së kësaj pasurie, znj. M. Sh., dhe bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, si dhe përdorimit në kushtet e mungesës së pronares së pasurisë²¹, nuk merr vlerë përcaktuese në krijimin e dyshimit të arsyeshëm për fshehje të pronarit *de facto*. Gjithashtu, u konstatua se shkak i tjetër mbi të cilin Komisioni bazoi konkluzionin e tij për përpjekje për fshehje, ishte sipas tij pamundësia e znj. M. Sh. për të justifikuar me të ardhura të ligjshme blerjen e kësaj pasurie në vlerën prej 30.000 USD në vitin 2004, përfundim ky që nga kontrolli i kryer në Kolegj, rezultoi produkt i një hetimi sipërfaqësor dhe jo të gjithanshëm, për sa kohë u konstatua se nuk është hetuar lidhur me të ardhurat e bashkëshortit të znj. Sh., i cili rezulton të jetë ndarë nga jeta në vitin 2000 dhe logjikisht duhet të ketë kontribuar në kursimet familjare të krijuara për financimin e këtij apartamenti në Tiranë në vitin 2005, sikundër nuk është hetuar se cila ka qenë gjendja familjare e znj. M. Sh. dhe raporti me djalin e saj S. Sh., me qëllim përfshirjen ose jo të tij në analizën financiare, në kuadër të verifikimit të aftësisë së saj blerëse në vitin 2005.
96. Për më tepër, akti “Prokurë e posaçme” nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 08.10.2012, përmbajtja e të cilit për Komisionin, në drejtim të afatit të pacaktuar dhe tagrave të dhënë përfaqësueses (bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit) ngre dyshimin e arsyeshëm se kjo mund të jetë pasuri e subjektit të rivlerësimit apo bashkëshortes së tij, rezulton që në paragrafin e parafundit të pjesës në të cilën citohen tagrat e përfaqësimit, përcakton në mënyrë të shprehur:

²¹ Duke qenë se ajo prej vitit 2009 jeton në Shtetet e Bashkuara të Amerikës së bashku me djalin e saj.

*Përfaqësuesja nuk ka të drejtën e tjetërsimit të pronës së mësipërme, por vetëm të lëshimit me qira duke gjetur subjektin kontraktues, vjelë qiranë, caktuar çmimin dhe prishë kontratën në qoftë se pala qiramarrëse nuk është korrekte në drejtim të detyrimeve kontraktore. Ky parashikim në aktin e përfaqësimit është vlerësuar nga trupi gjykues si një sjellje tipike e pronarit të vërtetë të sendit dhe që nuk krijon asnjë premisë për ngritjen e ndonjë dyshimi të arsyeshëm në drejtim të një pronësie *de facto* nga ana e subjektit të rivlerësimit apo bashkëshortes së tij, sa kohë këtyre të fundit u është kufizuar disponimi lirisht i sendit, karakteristika themelore e një marrëdhënieje pronësie dhe tagri kryesor i pronarit mbi sendin.*

97. Në përfundim të sa më sipër, trupi gjykues e gjen të drejtë dhe të bazuar shkakun e mësipërm të ankimit të subjektit dhe, për rrjedhojë, konkluzioni i Komisionit lidhur me vlerësimin e pasurisë në përdorim të subjektit të rivlerësimit, çmohet i gabuar pasi nuk mbështetet në fakte.
98. *Lidhur me shkakun e ankimit mbi vlerësimin e të ardhurave të personit të lidhur/djalit të subjektit të rivlerësimit E.D., që kanë shërbyer për blerjen e automjetit tip “Toyota Camry” me vlerë 64000 USD dhe pagesat për shkollimin e vajzës së subjektit të rivlerësimit, si dhe mbi të ardhurat dhe shpenzimet e personit të lidhur/vajzës së subjektit të rivlerësimit A.D., trupi gjykues vëren:*
99. Komisioni ka arsyetuar në vendim lidhur me çështjen e të ardhurave të djalit të subjektit të rivlerësimit: *Komisioni, pasi shqyrtoi dhe analizoi shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit dhe deklaratimet e bëra në seancë dëgjimore, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk shpjegoi bindshëm burimin dhe ligjshmërinë e të ardhurave të personit të lidhur/djalit të tij për pagimin e kredisë së blerjes së makinës në shumën prej 64000 USD, sipas kësteve të pagesës. [...] Personi i lidhur/djali i subjektit të rivlerësimit nuk arriti të provojë me dokumentacion ligjor justifikues ligjshmërinë e të ardhurave që kanë shërbyer për të shlyer këstet e kredisë financiare të automjetit, tip “Toyota Camy”, si dhe shumën prej 15.000 USD për pagesën e shkollës së personit të lidhur/vajzës së subjektit. Ndërsa sa u takon të ardhurave dhe shpenzimeve të personit të lidhur/vajzës së subjektit të rivlerësimit ka arsyetuar: Komisioni, pasi shqyrtoi dhe analizoi shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit dhe deklaratimet e bëra në seancë dëgjimore, arrin në përfundimin se personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit/vajza e tij ka bërë deklaratim të pasaktë të të ardhurave të saj në deklaratën “vetting” të vitit 2017, pasi ka mospërputhje të shumës së të ardhurave krahasuar me deklaratimin e bërë në deklaratën e interesave private, periodikë vjetorë 2016. Subjekti i rivlerësimit nuk provoi me dokumentacion ligjor provues pagesën e kryer pranë “{***}” për një semestër. Kështu që nuk është e qartë se sa ka qenë shuma e paguar për shkollimin e vajzës në këtë universitet. Subjekti i rivlerësimit ka fshehur shpenzimet reale të shkollimit të vajzës, ku sipas dokumentacionit rezultoi 8721836,651 lekë, ndërkohë që subjekti ka deklaruar vetëm 5.128950 lekë. Subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaratim të rremë dhe jo në përputhje me ligjin në lidhje me burimin e financimit të studimeve të vajzës, pasi në deklaratimet periodike të viteve 2012, 2013, 2014, subjekti deklaroi se i ka financuar nga të ardhurat e tij, ndërsa referuar deklaratimeve të subjektit si pjesë të përgjigjeve të pyetësorit, shpenzimet për këtë periudhë në lidhje me studimet janë mbuluar nga kontributi i djalit dhe në mënyrë modeste nga të ardhurat që siguronte vajza në fundjavë. Si konkluzion, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në mënyrë të rreme shpenzimet e kryera për shkollimin e vajzës, duke i paraqitur ato në mënyrë të pasaktë.*
100. Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi konkluzionet e mësipërme të Komisionit lidhur me këto çështje, sipas shkaqeve të ngritura në ankimin e tij, si më poshtë.

100.1. Subjekti kundërshtoi si të gabuar dhe të pabazuar konkluzionin e Komisionit se ky i fundit ka fshehur shpenzimet reale të shkollimit të vajzës së tij, ku sipas dokumentacionit

rezultuan 8.721.836,651 lekë, ndërkohë që subjekti ka deklaruar vetëm 5.128.950 lekë, me pretendimin se ai ka deklaruar vetëm kontributin e dhënë prej tij për shkollimin e vajzës dhe se, përveç vlerave të deklaruara në deklaratat periodike vjetore për vitet 2011-2015, ai nuk ka dhënë asnjë kontribut tjetër për shkollimin e vajzës. Për pjesën tjetër të shpenzimeve, subjekti pretendon se ka dhënë shpjegime me detaje, sipas të cilave kontributi ka ardhur nga djali i tij dhe në mënyrë modeste nga vetë vajza, sikundër dhe në raste të veçanta ka kontribuar edhe kunati, z. S. Sh., i cili ka pasur burime të kënaqshme jetese.

100.2. Subjekti kundërshtoi si të pabazuar edhe konkluzionin e Komisionit se në deklaratimet periodike të viteve 2012, 2013 dhe 2014 ai ka kryer deklaratim të rremë në lidhje me burimin e financimit të studimeve të vajzës duke deklaruar se i ka financuar nga të ardhurat e tij, me pretendimin se ai asnjëherë nuk ka pranuar faktin se i ka financuar studimet e vajzës (në tërësinë e tyre) me të ardhurat e tij, por vetëm sa ka deklaruar në deklaratat periodike vjetore.

100.3. Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi si të pabazuar në fakte dhe prova konkluzionin e Komisionit lidhur me mosshpjegimin bindshëm të burimit dhe ligjshmërisë së të ardhurave të personit të lidhur, djalit të tij E. D., dhe dorëzimin e dokumentacionit ligjor justifikues për pagimin e kësteve të kredisë për blerjen e automjetit në vlerën prej 64.000 USD, si dhe të shumës prej 15.000 USD për pagesën e shkollës së personit të lidhur, vajzës së subjektit të rivlerësimit, me pretendimin se:

(i) Lidhur me çështjen e pagesës së çmimit të automjetit, ai ka dorëzuar dokumente ligjore justifikuese pranë Komisionit, sipas të cilave djali i tij ka paguar tërësisht detyrimin prej rreth 64.000 USD shoqërisë që i ka shitur automjetin. Subjekti shprehet në ankim se, për efekt të të provuarit të sa më sipër, paraqet një ekstrakt të nxjerrë nga kompania {***}, ku rezulton se djali i tij ka likuiduar shumën prej 64.753,55 USD²² dhe kërkon marrjen sërish të kësaj prove të dorëzuar dhe në Komision, por në një formulim të ndryshëm, më të qartë.

(ii) Lidhur me mbulimin e shpenzimeve të shkollimit të vajzës së tij në vlerën prej 15.000 USD, i ka dorëzuar Komisionit dy akte (shkresa) nxjerrje llogarie nga banka, për të ardhurat që ka siguruar djali për shërbimet ndaj të tretëve, sipas të cilave në periudhën mars - prill 2016, që përkon me periudhën e përfundimit të semestrit të fundit shkollor të vajzës (në shkollën publike {***}) janë derdhur në favor të djalit E. D. rreth 21.000 USD, provë kjo të cilën Komisioni, sipas subjektit të rivlerësimit, nuk e ka marrë në analizë.

101. Në shqyrtim të shkakut të ankimit të parashtruar në nënparagrafin 100.1 më sipër, trupi gjykues, pasi verifikoi aktet e fashikullit lidhur me shpenzimet e shkollimit të personit të lidhur (vajzës së subjektit të rivlerësimit), konstatoi se subjekti i rivlerësimit, në përputhje me detyrimin e përcaktuar nga dispozitat e ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, i ndryshuar ka deklaruar në formën shpenzimit të deklarueshëm vlerën monetare totale të shpenzuar prej tij në mbulimin e shpenzimeve të shkollimit dhe jetesës së vajzës në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Konkluzioni i Komisionit për fshehje të shpenzimeve reale të shkollimit të vajzës së tij (duke iu referuar këtu vlerës prej 8.721.835 lekësh, që u korrespondon shpenzimeve totale të shkollimit për periudhën 2012 - 2016), në krahasim me atë të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në formën e shpenzimit të kryer për qëllimet e arsimimit të vajzës, në vlerën prej 5.128.950 lekësh, do të qëndronte nëse detyrimi financiar ndaj subjekteve të huaja të arsimit të lartë do të kishte lindur në emër të subjektit të rivlerësimit. Për rrjedhojë, trupi gjykues nuk e gjen të bazuar konkluzionin e Komisionit për fshehje të shpenzimeve reale të shkollimit të vajzës nga subjekti i rivlerësimit.

²² Këtë dokumentacion të cituar në ankim, subjekti e ka përcjellë me kërkesën drejtuar Kolegjit në datën 25.09.2020.

102. Sa i takon shkakut të ankimit sipas nënparagrafit 100.2, trupi gjykues, pasi verifikoi dhe shqyrtoi deklaramet e kryera ndër vite nga subjekti i rivlerësimit, përkatësisht në DIPPV-të e viteve 2012, 2013, 2014 dhe 2015, përgjigjet e dhëna në pyetësorin shtesë nr. 3 të Komisionit, si dhe parashtrimet e tij në ankim, konstatoi se deklaramet e subjektit të rivlerësimit sa i takon burimit të financimit nuk janë kontradiktore dhe, për rrjedhojë, konkluzioni i Komisionit për deklarim të rremë të burimit është i pabazuar në prova. Pavarësisht mungesës së mospërputhjeve në deklaramet e burimeve të mbulimit të shpenzimeve totale të shkollimit, trupi gjykues konstatoi mospërputhje të vlerave të shpenzuara nga subjekti i rivlerësimit, në kuptim të shpërndarjes së këtyre shpenzimeve të deklaruara sipas viteve akademike në vite kalendarike (vite deklarimi), gjë që e bën deklaramin e subjektit në këto vite lidhur me shpenzimet e kryera për arsimimin e vajzës së tij të pasaktë.
103. Në shqyrtim të shkakut të ankimit të subjektit të rivlerësimit të parashtruar në nënparagrafin 100.3 (i), trupi gjykues vlerësoi se ky pretendim është i pabazuar, duke qenë se dokumentacioni i dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit, me të cilin provohet shlyerja e pagesës së kësteve të kredisë për blerjen e automjetit tip “Toyota Camy”, nuk adreson konkluzionin e Komisionit, sipas të cilit personi i lidhur (djali i subjektit të rivlerësimit) nuk arriti të shpjegojë bindshëm shlyerjen e kësteve me burime të ligjshme, në kuptim të standardit të kërkuar nga neni D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, edhe kërkesa e subjektit për çeljen e hetimeve me qëllim të provuarin e pagesës së plotë të detyrimit prej rreth 64.000 USD shoqërisë që i ka shitur automjetin djalit të tij E. D., bazuar në nenin 49, pika 6, germa “d” e ligjit nr. 84/2016, nuk u pranua nga trupi gjykues, pasi marrja e kësaj prove nuk ndikon në përfundimin e arritur nga Komisioni lidhur me mungesën e burimeve të ligjshme të djalit të subjektit të rivlerësimit për të justifikuar pagesën e kësteve të kredisë.
104. Sa u takon pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, të parashtruara në paragrafin 100.3 (ii) lidhur me aftësinë financiare të djalit të tij E. D. për mbulimin e shpenzimeve të shkollimit të vajzës së tij, në vlerën prej 15.000 USD, trupi gjykues, pasi shqyrtoi pretendimet e subjektit të rivlerësimit në ankimin e tij lidhur me këtë çështje, vlerësoi aktet e administruara gjatë hetimit të Komisionit lidhur me sa më sipër, arriti në përfundimin se konkluzioni i Komisionit është i drejtë dhe mbështetet në faktet e provuara gjatë hetimit, sipas të cilave personi i lidhur, djali i subjektit të rivlerësimit, pavarësisht faktit që ka krijuar të ardhura të konsiderueshme ndër vite nga puna e tij në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, niveli i të ardhurave të ligjshme në kuptim të standardit të kërkuar nga neni D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës nuk justifikon mbulimin e shpenzimeve të tij për blerjen e automjetit tip “Toyota Camy” në vlerën prej 64.000 USD dhe mbulimin e shpenzimeve të deklaruara për shkollimin e motrës së tij (vajzës së subjektit të rivlerësimit) në vlerën e 15.000 USD, në përputhje me parashikimet e nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.
105. Duke qenë se çështja e shpenzimeve të shkollimit të vajzës së subjektit të rivlerësimit nuk mund të shihet e shkëputur nga analiza e kryer mbi të ardhurat e ligjshme të krijuara nga djali i subjektit të rivlerësimit, në kushtet që ky i fundit është deklaruar rregullisht nga subjekti i rivlerësimit se ka mbështetur financiarisht vajzën e tij, konkluzioni mbi pamjaftueshmërinë e burimeve të ligjshme të E.D. sjell pasojë në rezultatin përfundimtar të analizës së mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për mbulimin e shpenzimeve totale, sipas shpërndarjes së tyre ndër vite, lidhur me arsimimin dhe jetesën e vajzës së subjektit të rivlerësimit në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, duke e vendosur këtë të fundit dhe subjektin e rivlerësimit në kushtet e deklaramet të pamjaftueshëm, sipas parashikimeve të nenit 33, pika 5, gjerat “a” dhe “b” të ligjit nr. 84/2016, për shkak të mungesës së burimeve të ligjshme për sa më sipër.

106. *Lidhur me shkaqet e ngritura nga subjekti i rivlerësimit në kundërshtim të vlerësimit që Komisioni u ka bërë të ardhurave të deklaruar nga subjekti në deklaratën e pasurisë “vetting”, sipas të cilit subjekti i rivlerësimit nuk provoi me dokumentacion ligjor të ardhurat në shumën prej 5.175.400 lekësh (si diferencë e të ardhurave të deklaruar në shumën 36.848.148 lekë me shumën e të ardhurave me dokumentacion justifikues ligjor prej 31.672.748 lekësh), trupi gjykues çmon se, përveç sa trajtuar më sipër në vendim lidhur me analizën e ligjshmërisë së të ardhurave që janë deklaruar nga subjekti i rivlerësimit dhe kanë shërbyer si burim për krijimin e pasurive të tij, objekt të deklaratës së pasurisë *vetting*, si dhe përcaktimin e efekteve të përlogaritjes ose jo të tyre në analizën financiare lidhur me mjaftueshmërinë e burimeve të ligjshme të subjektit të rivlerësimit, çështjet e tjera të ngritura nga Komisioni, lidhur me të ardhurat e deklaruar nga subjekti i rivlerësimit dhe konkluzioni i arritur në këtë kuadër, nuk prodhojnë asnjë efekt në vlerësimin e çështjes së rivlerësimit për subjektin Luan Dervishi.*
107. Sa i takon shqyrtimit të shkaqeve të ankimit lidhur me analizimin financiar të deklarimeve të subjektit të rivlerësimit ndër vite, trupi gjykues, pas vlerësimit të akteve të fashikullit, konstatoi se konkluzioni i arritur nga Komisioni në drejtim problematikave të evidentuara në deklaratimet e subjektit ndër vite, është i gabuar. Trupi gjykues vlerësoi se problematikave të deklarimeve ndër vite pranë ILDKPKI-së, janë analizuar gjatë procesit të vlerësimit dhe kontrollit të pasurive në momentin e krijimit dhe konkluzionet lidhur me to janë bërë pjesë e analizës dhe e konkluzioneve të arritura nga trupi gjykues mbi këto pasuri dhe, për rrjedhojë, nuk mund të rivlerësohen në forma të tjera, të ndryshme, paraqitjeje nga ana e Komisionit.

Ç. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit, lidhur me kriterin e aftësive profesionale

108. Subjekti i rivlerësimit e kundërshtoi vlerësimin e Komisionit mbi kriterin e aftësive profesionale si vlerësim me qëndrime tendencioze, të njëanshme, me një standard të ulët profesional dhe në shkëlqje të hapur me dispozitat e ligjit nr. 96/2016 dhe ligjit nr. 84/2016, duke qenë se, sipas tij, Komisioni për vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit ka përzgjedhur për të marrë në shqyrtim 3 vendime gjyqësore në lëndë penale të vitit 2017 dhe jo vendimet e shortuara sipas procedurës ligjore.
109. Lidhur me këtë pretendim të subjektit të rivlerësimit, nga shqyrtimi i akteve të fashikullit të Komisionit, konstatohet se ky i fundit, përveç raportit të hollësishëm të përcjellë nga Inspektorati i KLD-së, ka administruar edhe vendimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit gjatë vitit 2017 dhe, lidhur me to, në rezultatet e hetimeve ka pasqyruar gjetje sa u takon tre prej këtyre vendimeve, të cilat referuar arsyetimit të Komisionit në vendim, nuk kanë ndikuar në arritjen e përfundimit lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale.
110. Në analizë të legjislacionit të zbatueshëm lidhur me vlerësimin e aftësive profesionale të subjekteve të rivlerësimit, trupi gjykues konstaton se referuar nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, relatori i çështjes përgatit relacionin për vlerësimin e aftësive profesionale mbështetur në raportin e inspektorëve, informacionin e marrë në burime të tjera, si dhe në kriteret e vlerësimit, të parashikuara në legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe akteve të tjera ligjore. Për rrjedhojë, referuar parashikimeve ligjore në fuqi, vlerësohet se, pavarësisht se Komisioni ka gabuar duke mos pasqyruar në mënyrë të hollësishme në vendim analizën lidhur me çështjet e shortuara dhe ato të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, ky fakt nuk nënkupton që vlerësimi i aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit nuk është bërë mbi bazën e çështjeve gjyqësore të shortuara sipas sistemit objektiv dhe atyre të përzgjedhura nga vetë subjekti. Për rrjedhojë, trupi gjykues e gjen të pambështetur pretendimin e subjektit të rivlerësimit.

111. Lidhur me shkakun e ngritur nga subjekti i rivlerësimit në ankim për kundërshtimin e konkluzionit të Komisionit, sipas të cilit subjekti i rivlerësimit në çështjen gjyqësore me të pandehur “S. M.” ka demonstruar mungesë të aftësive organizative të një gjyqtari, subjekti i rivlerësimit pretendoi se ai nuk ka qenë kryesuesi i trupit gjykues që ka gjykuar këtë çështje dhe, pavarësisht se nuk përjashtohet nga përgjegjësia procedurale e anëtarit të trupit gjykues, drejtimi i procesit gjyqësor mbetet detyrë dhe përgjegjësi e kryesuesit. Gjithashtu subjekti parashtroi se në çdo rast një përfundim i tillë i Komisionit nuk mund të jetë produkt i një çështjeje të vetme, por i një procesi vlerësimi në tërësi dhe, në këtë drejtim, subjekti pretendon se ai ka pasur një vlerësim shumë të mirë nga KLD-ja edhe në kriterin e shpejtësisë dhe menaxhimit të dosjeve gjyqësore dhe, mbi të gjitha, në rastin e inspektimit të iniciuar nga ministri i Drejtësisë lidhur me çështjen “{***}” nuk është propozuar asnjë masë disiplinore nga ministri pas inspektimit të kryer nga Ministria e Drejtësisë në vitin 2015.
112. Lidhur me këtë çështje, Komisioni në mënyrë të përmbledhur ka arsyetuar në vendim: *Subjekti i rivlerësimit ka demonstruar mungesë të aftësive organizative të një gjyqtari. Përfundimet e nxjerra nga dokumentacioni që disponon nga Ministria e Drejtësisë dhe faktet e bëra publike në media dhe shqyrtimi i pavarur i këtij rasti në tërësinë e tij, janë të pamjaftueshme për t’u konsideruar si shkaqe për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit sipas parashikimeve të nenit 61, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, por ato merren në konsideratë në vlerësimin tërësor të çështjes së subjektit të rivlerësimit, sipas nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.*
113. Në shqyrtim të këtij shkakun të ankimit të subjektit të rivlerësimit, nga verifikimi i akteve të fashikullit të Komisionit, trupi gjykues konstatoi se pas inspektimit të kryer nga Ministria e Drejtësisë në Gjykatën e Apelit Shkodër, në zbatim të urdhrin të ministrit të Drejtësisë nr. {***}, datë 06.07.2015, në lidhje me çështjen penale në ngarkim të të gjykuarit S. M., ministri i Drejtësisë, sikundër pretendoi edhe subjekti i rivlerësimit, nuk ka propozuar pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë marrjen e ndonjë mase disiplinore në ngarkim të subjektit të rivlerësimit Luan Dervishi, i cili në gjykimin e kësaj çështjeje penale paraqitet në cilësinë e anëtarit të trupit gjykues.
114. Referuar përcaktimeve ligjore në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 96/2016”), lidhur me kriteret e vlerësimit të aftësive profesionale të gjyqtarëve, konstatohet që, referuar nenit 74 të këtij ligji, aftësia organizative e gjyqtarit, në drejtim të aftësisë për të përballuar ngarkesën në punë, matet duke u bazuar në treguesit për respektimin e afateve ligjore, plotësimin e standardeve minimale kohore, kohën mesatare që i dedikohet çdo çështjeje dhe kohën mesatare për marrjen e vendimit përfundimtar gjyqësor. Gjithashtu, në zbatim të nenit 42, pika 1 dhe nenit 43 të ligjit nr. 84/2016, si dhe nenit 77 të ligjit nr. 96/2016, vlerësimi përfundimtar lidhur me secilin prej kriterëve të vlerësimit të aftësive profesionale të magjistratit, në rastin në fjalë lidhur me kriterin e “aftësive organizative”, duhet të jetë produkt i vlerësimit tërësor të burimeve të përcaktuara me ligj dhe jo i bazuar në një burim të vetëm vlerësimi, e aq më pak të një çështjeje të vetme.
115. Për më tepër, sa i takon kriterit të “aftësive organizative”, vlerësohet se në rastet e gjykimit të çështjeve në trup gjyqësor, përgjegjësia e gjyqtarit në përmbushjen e afateve ligjore duhet vlerësuar në raport me rolin dhe cilësinë e tij në trupin gjykues, duke mbajtur në konsideratë në këtë drejtim edhe dispozitat e legjislacionit procedural penal apo/dhe civil lidhur me kompetencat dhe përgjegjësitë e kryesuesit të trupit gjykues në administrimin dhe drejtimin e procesit gjyqësor. Jo pa qëllim çështjet e shortuara dhe ato të përzgjedhura nga subjektet për efekt të vlerësimit të kriterit të aftësive profesionale, në rastet kur gjykimi bëhet në mënyrë

kolegjiale, u korrespondojnë gjithmonë çështjeve ku subjektet kanë pasur cilësinë e gjyqtarit kryesues (relator) të çështjes.

116. Sa i takon konkluzionit të Komisionit se në gjykimin e çështjes objekt kontrolli, subjekti i rivlerësimit nuk ka respektuar parashikimet e nenit 152/1,2 të Kodit të Procedurës Penale dhe 375 të Kodit të Procedurës Penale. Kjo pasi duke ndryshuar cilësimin juridik të veprës, gjykata ka lehtësuar pozitën e të pandehurit dhe, për më tepër, pas përsëritjes së pjesëshme të hetimit gjyqësor, nuk rezultoi që nga analiza e vlerësimit të fakteve dhe dëshmive të dëshmitarëve të pyetur, të kenë diktuar gjykatën për të ndryshuar cilësimin juridik të veprës, trupi gjykues vlerëson se, referuar nenit 375 të Kodit të Procedurës Penale, gjykata me vendimin përfundimtar mund t'i japë faktit një përcaktim të ndryshëm nga ai që ka bërë prokurori, më të lehtë ose më të rëndë, me kusht që vepra penale të jetë në kompetencën e saj. Për rrjedhojë, për sa kohë vepra penale ka qenë në kompetencë të Gjykatës së Apelit Shkodër, ndryshimi i cilësimit juridik të saj nuk ka qenë në shkelje të dispozitës së sipërcituar. Ndërsa sa i takon vlerësimit mbi korrektësinë apo jo të këtij vendimi të trupit gjykues të Gjykatës së Apelit Shkodër, referuar përcaktimeve të nenit 72, pika 4 e ligjit nr. 96/2016, kjo çështje e tejkalon objektin e vlerësimit të aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit, aftësitë gjyqësore të të cilit çmohen pa gjykuar korrektësinë e vendimit dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e tij.
117. Në përfundim të sa më sipër, trupi gjykues arriti në përfundimin se në rastin në gjykim, konkluzionet e sipërcituara të Komisionit janë të pamjaftueshme për të arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, si pasojë e veprimeve dhe mosveprimeve të tij në gjykimin e çështjes penale të sipërpërmendur, ka cenuar besimin e publikut sipas nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.
118. Në përfundim të shqyrtimit të çështjes, trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, bazuar në analizën e mësipërme, arrin në këto konkluzione:
- Për pasurinë e llojit “tokë truall”, me sip. 365 m², në bashkëpronësi me të tjerë, me pjesë takuese 46,8 m², në {***}, Tiranë, subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pasaktë pasi nuk ndodhet në kushtet e parashikuara në nenin 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016.
 - Për pasurinë e llojit “apartament banimi”, me sipërfaqe 125 m², si dhe një garazh me sip. 40 m², ndodhur në rr “{***}”, Tiranë me vlerë ndërtimi 2.500.000 lekë, subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pasaktë të burimeve të krijimit të kësaj pasurie në deklaratën e pasurisë *vetting*, pasi nuk ndodhet në kushtet e parashikuara në nenin 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016.
 - Lidhur me pasurinë e luajtshme të llojit autoveturë, e tipit “Ford Focus”, me vlerë 14.000 euro, subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të rremë të burimeve të krijimit të kësaj pasurie në deklaratën e pasurisë *vetting*, si dhe ndodhet në kushtet e pamjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për financimin e blerjes së këtij sendi në vitin 2011, në kuptim të parashikimeve të nenit 33, pika 5, gjerat “a”, “b” dhe “ç” të ligjit nr. 84/2016.
 - Personi i lidhur, djali i subjektit të rivlerësimit, E. D., ndodhet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për blerjen e automjetit tip “Toyota Camry”, me vlerë 64.000 USD dhe mbulimin e shpenzimeve për shkollimin e personit të lidhur të subjektit të rivlerësimit, znj. A. D., në kuptim të parashikimeve të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.
 - Subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e deklarimit të pasaktë dhe në mungesë të burimeve të ligjshme për mbulimin e shpenzimeve të shkollimit të personit të lidhur, vajzës së tij, A. D., në kuptim të nenit 33, pika 5, gjerat “a” dhe “b” të ligjit nr. 84/2016.

Për rrjedhojë, bazuar në nenin D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës dhe nenet 33, pika 5, gjerat “a”, “b”, “ç” dhe 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vlerëson se vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Luan Dervishi duhet të lihet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 83, datë 26.11.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit që i përket subjektit të rivlerësimit Luan Dervishi.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, më datë 01.10.2020, në Tiranë.

ANËTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

ANËTARE

Ina RAMA

nënshkrimi

ANËTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

RELATOR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

KRYESUES

Ardian HAJDARI

nënshkrimi

MENDIM PARALEL

1. Unë, gjyqtare Natasha Mulaj, në cilësinë e anëtares së trupit gjykues, jam dakord me vendimin nr. 25, datë 01.10.2020, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (në vijim “Kolegji”), për lënien në fuqi të vendimit nr. 83, datë 26.11.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), që i përket subjektit të rivlerësimit Luan Dervishi.
2. Nuk jam dakord me arsyetimin e përdorur nga shumica e anëtarëve të trupit gjykues për sa vijon.
 1. **Për pasurinë “truall”, me sipërfaqe 365 m², ndodhur në {***}, Tiranë, në bashkëpronësi me të tjerë, me pjesë takuese 46,8 m², Zona Kadastrale {***}, regjistruar nr. {***}, më datë 25.09.1998**

Komisioni për këtë pasuri ka arritur ndër të tjera në konkluzionet se:

- subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë që personat e tjerë të lidhur/dhuresit e këtij trualli kishin të ardhura nga burime të ligjshme për këtë dhurim të bërë, sipas detyrimit të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, i cili specifikon se: “Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, ose persona të tjerë të lidhur, të deklaruar në cilësinë e dhuresit, huadhënësit ose huamarrësit, nëse konfirmojnë këto marrëdhënie, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive”;
 - në lidhje me provën e re të dërguar nga ana e subjekti të rivlerësimit, deklaratën noteriale, datë 20.11.2018, Komisioni çmon se kjo deklaratë ka vetëm efekt deklarativ për të konfirmuar faktin, por ajo nuk provon të ardhurat e ligjshme të dhuresit;
 - subjekti i rivlerësimit Luan Dervishi, ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme nga ana e Sh. B., për të justifikuar vlerën e truallit të dhuruar atij.
3. Pas shqyrtimit të çështjes në Kolegj, shumica e trupit gjykues ka vendosur që subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë, pasi nuk ndodhet në kushtet e parashikuara në nenin 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016.

Nga shqyrtimi dhe analizimi i dokumentacionit të administruar në dosjen gjyqësore, ka rezultuar që subjekti i rivlerësimit:

- në deklaratën e personit që mbart detyrim për deklarim pasurie, në vitin 2003, ka deklaruar: sipërfaqe trualli në bashkëpronësi, me sipërfaqe 48 m², vlefte 2.400 USD, me burim krijimi të ardhurat nga puna, [...] në marrëdhënie me shtetin,
 - në deklaratën e pasurisë për rivlerësim “vetting” 2017, subjekti i rivlerësimit deklaroi truall për ndërtim, dhuruar në bazë të kontratës, nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 25.09.1998,
 - në deklaratimet e tij me anë të postës elektronike të datës 20.09.2018, subjekti deklaroi se kjo pronë i është dhuruar, duke shpjeguar se gjatë kohës që ka punuar në Gjykatën e Rrethit Përmet ka pasur marrëdhënie miqësie me z. M. M. e z. A. B. dhe meqenëse ishte larguar njëri nga porositësit, subjekti është ftuar për të marrë pjesë si porositës nga personat e mësipërm. Për këtë qëllim, subjekti deklaroi se ka firmosur kontratën e dhurimit pa njohur arsyen e vërtetë, pasi nuk ka qenë pjesë e negociatave.
4. Referuar akteve shkresore të marra në shqyrtim në cilësinë e provës nga Komisioni dhe në Kolegj, ka rezultuar që trualli me sipërfaqe 365 m² t’u jetë shitur blerësve M. M. dhe Sh. B. nga trashëgimtarët e familjes B., me kontratë shitblerjeje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 28.08.1998, në vlerën 2.000.000 lekë, shumë e cila është likuiduar totalisht nga blerësit jashtë zyrës së noterisë.

Një muaj më pas, trualli më sipër i dhurohet me kontratë dhurim trualli nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 25 shtator 1998, shtetasve A.B., M. M., E. Sh., Q. N. dhe I. M., Luan Dervishi dhe H. B.

Në datën e nënshkrimit të kontratës së dhurimit, 25 shtator 1998, nënshkruhet kontratë sipërmarrjeje nr. {***} rep., nr. {***} kol., për ndërtimin e një godine pesëkatëshe [...], mes përfituesve të dhurimit cituar më sipër e M. M. në cilësinë e porositësve dhe sipërmarrësit M. L..

5. Në vijim të arsyetimit të shumicës (paragrafi 28, germat “ç”, “d”, “dh”):

Me prokurën e posaçme nr. {***} rep., nr., {***} kol., datë 11.08.1998, përcjellë me shkresën e ALUIZNI-t nr. {***} prot., datë 25.10.2018: të përfaqësuarit T. B. dhe H. B. kanë caktuar si përfaqësuesit e tyre Sh.dhe H. B., me tagra që të dy së bashku apo veç e veç të tërheqin nga Banka e Kursimeve Berat gjithë shumën e lekëve që ne kemi depozitë pranë kësaj banke duke pasur ata të drejtë që këtë shumë prej 2.000.000 lekësh ta administrojnë për blerje ose ndërtim të një banese ose lokali në qytetin e (Beratit) prishet një fjalë, e Tiranës. Ata kanë të drejtë të blejnë truall, si dhe të lidhin kontrata sipërmarrëse [...].

Në deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 20.11.2018, të shtetasve Sh. dhe H. B., kjo e fundit deklaron se Luan Dervishi me të cilin kam lidhje shoqërore sipas deklarimeve të mësipërme të bashkëshortit tim, më ka dorëzuar mua me dy deklarata dore shumë prej 354.600 lekësh (treqind e pesëdhjetë e katër mijë e gjashtëqind lekësh), e cila është e barasvlefshme me shumë prej 2400 USD (dymijë e katërqind dollarë amerikanë sipas kursit të kohës), që përfaqëson vlerën e truallit të paguar më parë nga kunati im B. B..

Subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ të Komisionit ka përcjellë pranë këtij të fundit dy shkresa të thjeshta të nënshkruara nga znj. H. B., sipas të cilave kjo e fundit deklaron marrjen e pagesës (në dy këste) prej subjektit të rivlerësimit Luan Dervishi të shumës totale prej 354.600 lekësh, që përfaqëson vlerën e kështit të shtëpive (truallit), të paguar në emër të I. B.. Sipas deklaratës së datës 16.10.1998, znj. H. B. shprehet: Me shlyerjen e kësaj vlere²³, z. Luan nuk ka më asnjë detyrim lidhur me shlyerjen e truallit [...].

6. Si dhe në përfundimin e arritur prej tyre (paragrafi 31 i vendimit):

[...] edhe pse origjina e krijimit të kësaj pasurie të paluajtshme është një kontratë dhurimi, për sa kohë në deklaratën për herë të parë të vitit 2003, subjekti ka deklaruar si shpenzim për krijimin e kësaj pasurie, vlerën prej 2400 USD, dhe në vijim, gjatë procesit të hetimit administrativ, ka dhënë shpjegime të hollësishme lidhur me këtë deklaram, duke i qëndruar këtij deklarami deri në fund, pavarësisht se në deklaratën e pasurisë vetting ka deklaruar aktin ligjor (kontratën e dhurimit) që ka shërbyer për kalimin e titullit të bashkëpronësisë mbi këtë sipërfaqe trualli, trupi gjykues arrin në përfundimin se, për nevojat e këtij procesi, mjaftueshmëria e burimeve të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie nga ana e subjektit të rivlerësimit, duhet të ishte vlerësuar nga Komisioni në drejtim të marrëdhënies së faktit të blerjes dhe jo asaj juridike të dhurimit, sipas parashikimeve të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.[...].

Sipas arsyetimit të shumicës rezulton që subjekti i rivlerësimit ka paguar për blerjen e këtij trualli.

Referuar analizës ligjore më sipër, çmoj se subjekti i rivlerësimit duke e paraqitur fitimin e pronës nëpërmjet blerjes në vitin 2003, pa e provuar me dokumentacion ligjor dhe në vitin 2017 e deklaron si të fituar me anë të dhurimit, të krijon bindjen se jemi para faktit të një deklarami të rremë, sipas parashikimeve të nenit 33, pika 5, germa “ç” e ligjit nr. 84/2016.

²³ I referohet këtu kështit të dytë prej 56.400 lekësh.

Fakti që në kontratën e dhurimit të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e rivlerësimit *vetting* 2017, nuk janë përcaktuar, si dhe nuk është hetuar mbi motivet dhe shkaqet që kanë çuar palët në lidhjen e kësaj kontrate dhurimi, kushte këto të domosdoshme për ekzistencën e një marrëdhënieje kontraktuale, çmoj se sjell për pasojë, pavlefshmërinë e vetë kontratës së dhurimit.

Në përfundim të gjithë sa më sipër, vlerësoj se ndodhemi në kushtet e zbatimit dhe të nenit 33, pika 5, germa “ç” e ligjit nr. 84/2016, për deklarim të rremë për mënyrën e fitimit të kësaj pasurie.

II. Për pasuritë apartament banimi me sipërfaqe 125 m², si dhe një garazh me sipërfaqe 40 m², ndodhur në rr. “{*}” Tiranë, me vlerë ndërtimi 2.500.000 lekë.**

7. *Për këtë pasuri, shumica e trupit gjykues ka arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pasaktë të burimeve të krijimit të kësaj pasurie në deklaratën e pasurisë “vetting”, pasi nuk ndodhet në kushtet e parashikuara në nenin 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016.*
8. Nga përmbajtja e akteve shkresore të administruara dhe analizuara në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, ka rezultuar se pasuritë apartament banimi dhe garazh objekt shqyrtimi, janë ndërtuar mbi pasurinë truall të analizuar më sipër.

Apartamenti i banimit me sipërfaqe 125 m² dhe garazhi me sipërfaqe 40 m² janë deklaruar për herë të parë nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e personit që mbart detyrim për deklarim pasurie, në vitin 2003, ku si burim krijimi deklaroi: *rrjedhur nga të ardhurat nga puna: *marrëdhënie pune me shtetin; *të ardhura nga puna si avokat; *shitja e shtëpisë së privatizuar 950.000 lekë; *shitja e një zyre 500.000 lekë.* Në deklaratën e pasurisë *vetting* 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si burim krijimi të ardhurat e krijuara nga puna ndër vite midis meje dhe bashkëshortes sime. I pyetur gjatë procesit të rivlerësimit lidhur me burimin e krijimit të këtyre pasurive, subjekti ka deklaruar se *burimi kryesor i të ardhurave kanë qenë kursimet e rrjedhura nga kontributi në punë midis meje dhe bashkëshortes sime. Burime të tjera jo nga puna kanë qenë: (i) shitja e banesës në masën prej 900.000 lekësh, fakt i deklaruar; dhe (ii) shitja e zyrës së punës, avokatisë, Librazhd, në masën prej 500.000 lekësh, fakt i deklaruar.*

9. Në qoftë se i referohemi analizës finaciare të kryer në Komision, subjekti i rivlerësimit ka rezultuar me mungesë të burimeve finaciare të ligjshme për krijimin e këtyre pasurive. Nëse shpenzimeve të subjektit u shtohet edhe kosto e blerjes së truallit në vlerën 2400 USD, sipas pretendimeve të subjektit, atëherë diferenca negative do të thellohet.
10. Për gjithë sa më sipër, çmoj se subjekti i rivlerësimit krahas pasaktësive në deklarime shoqëruar me mungesë të burimeve finaciare të ligjshme, ka kryer deklarim të rremë sipas parashikimeve të nenit 33, pika 5, germa “ç” e ligjit nr. 84/2016.

III. Në lidhje me të ardhurat nga qiraja e këtij apartamenti dhe garazhi në vitet 2013, 2014 dhe 2015

11. Jam dakord me arsyetimin e Komisionit për të mos marrë në konsideratë në analizën finaciare të kryer, të ardhurat nga dhënia me qira e apartamentit dhe garazhit të sipërcituar, përfituar nga subjekti i rivlerësimit për vitet 2013, 2014 dhe 2015, pasi në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, ku parashikohet se *subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm burimin e*

ligjshëm të pasurive dhe të ardhurave. Pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore [...], ndodhur në kushtet kur institucioni përgjegjës, Drejtoria Rajonale e Tatimeve Tiranë, nuk konfirmon pagimin e detyrimeve tatimore që rrjedhin nga të ardhurat më sipër, vlerësoj se këto të ardhura nga qiratë nuk mund të konsiderohen si të ardhura nga burime te ligjshme.

GJYQTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi